



**Përmbledhje Jo Teknike e Vlerësimit të
Ndikimit në Mjedis të pusit vlerësues
Shpirag-5, në Bllloqet 2-3, Shqipëri**

Korrik / 2021

Tirana, Albania

PËRMBLEDHJE RAPORTI

PROJEKTI	Leje Mjedisi TIPI A-Shpirag 5 Alternativa D
TITULLI I DOKUMENTIT	Përmbledhje Joteknike-Shpirag 5 Alternativa D

Nr.	QËLLIMI I ÇËSHTJES	VËREJTJE / PËRSHKRIMI	HARTOI	DATË
1	Draft	Rishikim i Brendshëm-Përmbledhje Joteknike	Abkons	28.06.2021
2	Konfirmuar nga Klienti	Rishikim	SHELL	02.07.2021
3	Final		Abkons	05.07.2021

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR

	KONSULENTI		
	Hartoi	Kontrolloi	Aprovoi
Emri/ Mbiemri	Enkeleda Sopaj Redion Biba	Redion Biba	Redion Biba
Nënshkrimi			
Datë	25/12/2020	26/12/2020	30/12/2020
Statusi i Dokumentit	Draft	Draft	Final

Table of Contents

Shkurtime	5
1. Hyrje	6
1.1. Qëllimi i Përmbledhjes Jo-Teknike	6
1.2. Përmbledhje e projektit Shpirag-5	6
1.3. Qëllimi i procesit të VNM-së	7
1.3.1. Përshkrimi i metodologjive të përgatitjes së raportit VNM	8
2. Përshkrimi i projektit	8
2.1. Qëllimi i Projektit	9
2.2. Historiku i projektit	9
2.2.1. Programi i zgjeruar i vlerësimit	9
2.2.1.1. Kërkimi dhe vlerësimi i mëparshëm	9
2.2.1.1.1. Plani aktual i Shpirag-5 dhe puset vlerësuese pasuese	9
3. Fazat e projektit të pusit vlerësues Shpirag-5	10
3.1.1.1. Përgatitja e sheshit dhe ndërtimi	10
3.1.1.1.1. Faza e shpimit	10
3.1.1.2. Vlerësimi afatshkurtër dhe i zgjeruar i pusit dhe vrojtimi i profilit sizmik vertikal	11
3.1.1.3. Sistemi Pilot i Vlerësimit dhe Shfrytëzimi për qëllime ekonomike (të dy fazat nuk janë pjesë e këtij procesi VNM-je)	12
3.1.1.1.1. Braktisja e pusit, çmontimi dhe rehabilitimi	12
3.2. Vendndodhja e Projektit	13
4. Analiza e alternativave të marra në shqyrtim	17
5. Të dhëna për gjendjen bazë të mjedisit	18
5.1. Hyrje	18
5.2. Mjedi Fizik	18
5.3. Biodiversiteti dhe habitatet	19
5.4. Gjendja e mjedisit socio – ekonomik dhe shëndetit	20
6. Analiza e ndikimeve të mundshme në mjedis	20
6.1. Metodologjia e vlerësimit të ndikimit	20
6.2. Identifikimi i Ndikimeve potenciale të Projektit	24
6.3. Ndikimet e Mundshme në Cilësinë e Ajrit	24
6.4. Potential Impacts from Odour generation	27
6.5. Ndikimet e mundshme nga Zhurmat, Dridhjet dhe Ndryçimi	28
6.5.1. Modelimi i Zhurmave	29
6.6. Ndikimet e mundshme në Tokë	31
6.7. Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësorë	33
6.8. Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë	34
6.9. Ndikimet e mundshme në biodiversitet dhe në habitatet natyrore	36

6.10.	Ndikimet e mundshme nga gjenerimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme.....	37
6.11.	Ndikimet e mundshme negative socio-ekonomike dhe shëndetësore	39
6.11.1.	Ndikimet në përdorimin e tokës dhe mjeteve të jetesës	40
6.11.2.	Ndikimet në peisazh dhe aspektet vizuale	40
6.11.3.	Ndikimet në shëndetin e komunitetit.....	42
6.11.4.	Ndikimet në punësim dhe ekonomi	43
6.11.5.	Ndikimet në infrastrukturën, shërbimet dhe ndërtesat e komunitetit	44
6.11.6.	Ndikimet në trashëgiminë kulturore	44
6.11.7.	Ndikimet nga aksidentet e mundshme mjedisore ose ngjarjet e paplanifikuara	45
7.	Ndikimet e mundshme ndërkufitare	46
8.	Ndikimet e mundshme pozitive të projektit	46
9.	Masat zbutëse për mbrojtjen e mjedisit bazuar në ndikimet negative të identifikuar	47
10.	Monitorimi mjedisor i zbatimit të projektit.....	66
11.	Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor	66

Shkurtime

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi European
BTU	Njësi Termike Britanike
BV	Kompani private
ETRS	European Terrestrial Reference System
GK	Gauß-Krüger
H ₂ S	Acidi Sulfidrik
HSSE&SP CF	Standartet mjedisore, sociale dhe shëndetësore të Shell
KFN	Korporatës Financiare Ndërkombëtare
KNP	Kontrata e Ndarjes se Prodhimit
MTE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PBR	Plani i Braktisjes dhe Rivendosjes
PJT	Përmbledhje Jo Teknike
PM	Particulates/ Grimcat
PMM	Plani i Menaxhimit Mjedisor
PMMM	Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit Mjedisor
PMMN	Plani i Menaxhimit Mjedisor të Ndërtimit
PRE	Plan për Reagimin ndaj Emergjencave
PSV	Profilizim Sizmik Vertikal
SPV	Sistem Pilot i Vlerësimit
UTM	Universal Transverse Mercator
VNM	Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Social
VOC	Volatile organic compound/ Përbërje organike e paqëndrueshme

1. Hyrje

1.1. Qëllimi i Përmbledhjes Jo-Teknike

Ky dokument përfaqëson një Përmbledhje Jo Teknike (PJT) të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) për projektin e propozuar të pusit vlerësues Shpirag-5 në Blloqet 2-3 në Shqipëri. Qëllimi i këtij Raporti Jo-teknik është aplikimi për hapjen e Konsultimit me Publikun për marrjen e Lejes Mjedisore për Shpirag 5 Pusin D.

Ai do të publikohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe do të ndahet me të gjithë Palët e interesuara për hapjen e Konsultimit me Publikun.

Dokumenti paraqet projektin, një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit fizik, biologjik dhe njerëzor në zonën e projektit, ndikimet kryesore mjedisore dhe sociale dhe detajon masat e planifikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur ose kompensuar këto ndikime. PJT ndjek të njëjtën strukturë si raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, Social, Shëndetësor.

Në emër të SUA, Royal Haskoning DHV Company zhvilloi një studim VNMS për Alternativën e propozuar A dhe B të Shpirag-5. Për këto zona SUA mori nga AKM një Deklaratë Mjedisore të lëshuar më 29.01.2020, e cila lejon SUA të vazhdojë me projektin.

Për shkak të arsyeve teknike, SUA ka vendosur të përfshijë dy lokacione alternative të projektit brenda rrezes pesë km të zonës së studimit të VNMS Shpirag-5, posaçërisht bllokun alternative të pusit C dhe D.

Në përputhje me VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për rregullat, përgjegjësitë, afatet kohore për procedurën e VNM-së dhe procedurën e transferimit të vendimit për deklaratën mjedisore", të ndryshuar, ABKONS sh.pk, një kompani këshilluese e licencuar, kreu studimin shtese për alternativën D e cila do të jetë dhe Alternativa që do të aplikohet për Leje Mjedisore.

1.2. Përmbledhje e projektit Shpirag-5

Shell Upstream Albania B.V. (këtu e më poshtë referuar Shell) është operatori i Kontratës me Ndarje Prodhimi (KNP) të Blloqeve 2-3 në tokë, në Shqipëri. Shell planifikon të kryejë brenda Blloqeve 2-3 shpimin e pusit vlerësues Shpirag-5, në një zonë në afërsi të fshatit Konisbaltë, i cili gjendet në territorin e Bashkisë Ura Vajgurore. Sheshi i pusit të propozuar Shpirag-5 i cili zë rreth 43,839.8 m² (384.38 ha) gjendet afër sheshit ekzistues të puseve Shpirag-2/4 të SUA-s dhe kampit të punëtorëve.

Figura më poshtë ep një pamje të përgjithshme të zonës ku mendohet të vendoset sheshi i pusit Shpirag-5, duke treguar sheshin e parapëlqyer dhe alternativ, përfshirë qytetet/fshatrat e afërt, rezervuarin e ujit

dhe sheshet e puseve ekzistues Shpirag-2/4 dhe Shpirag-3 si dhe kampin ekzistues.




Figure 1. Harta topografike me vendodhjet alternative të propozuara për sheshin e shpimit dhe zonën përreth, rezervuarin e ujit, sheshet e shpimit të puseve ekzistues Shpirag-2/4 dhe Shpirag-3 dhe kampin.

Shpirag-5 është një pus vlerësues i cili shërben për të vlerësuar nëse ka rezerva të mjaftueshme që të garantojnë një zbulim fitimprurës. Pusi vlerësues do të ketë si objektiv një strukturë nëntokësore shumë të thellë të quajtur “Shpiragu”; kjo është një strukturë që pritet të përmbajë naftë ose gaz. Qëllimi i projektit është të ndihmojë të përcaktohet nëse ky rezervuar përmban hidrokarbure (naftë e lehtë, kondensat dhe gaz natyror) ekonomikisht të shfrytëzueshme.

1.3. Qëllimi i procesit të VNM-së

Objektivat e VNM-së janë që:

- Të japë informacion për sfondin e projektit dhe ndërveprimet e mundshme të tij me receptorët mjedisorë e socialë në zonën e projektit;
- Të identifikojë ndikimet e mundshme të projektit të hartuar;
- Të konsultohet me palët e interesit dhe me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe të marrë opinionet e tyre për projektin;
- Të përmbushë kërkesat e procedurës së VNM-së në Shqipëri dhe standartet e performancës së Korporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) dhe në rast të mungesës së akteve rregullatore të zbatojë rregulloret e BE;
- Të informojë palët e interesit dhe publikun në tërësi për rezultatet e studimit, të marrë opinionet dhe shqetësimet e tyre dhe t'i përfshijë ato në studim;
- Të mundësojë kontributin e të gjithë palëve të interesit përmes një procesi të vrojtimit social dhe

dëgjësës publike.

Në këtë fazë të zhvillimit të projektit, është përgatitur draft Raporti VNM dhe do të dorëzohet pranë autoritetit rregullator (MTM). Kjo shënon fillimin e procedurës së njoftimit dhe fushatës së komunikimit të projektit e cila zgjat 30 ditë dhe pasohet nga Dëgjesa Publike në zonën e projektit. Kërkesat, shqetësimet dhe sugjerimet e këtyre fazave do të analizohen dhe adresohen në versionin final të Raportit VNM-së.

1.3.1. Përshkrimi i metodologjive të përgatitjes së raportit VNM

Tabela 1 tregon hapat e zhvillimit të raportit VNM.

Table 1. Hapat e zhvillimit të VNM-së

Hapat	Vërejtje/shënime
1	Kryerja e vrojtimit në terren për procesin e përcaktimit të çështjeve (të VNM-së)
2	Zhvillimi i angazhimit fillestar me palët përkatëse të interesit
3	Dorëzimi i Raportit të përcaktimit të çështjeve tek autoritetet (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) me datë 8 Maj 2018
4	Kryerja e vrojtimit në terren për gjendjen e mjedisit si: zhurma, cilësia e ujërave, biodiversiteti, arkeologjia, vrojtimit sociale, të nevojshme për VNM-në
5	Kryerja e vlerësimit të ndikimit duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit shqiptar, masat operacionale standarte të Shell dhe kërkesat e performancës së KFN, dhe kur është e përshtatshme rregulloret e BE
6	Zhvillimi i masave zbutëse kur janë të nevojshme
7	Zhvillimi i fushatës informuese dhe organizimi i Dëgjësës Publike
8	Dorëzimi i Raportit final VNM tek autoritetet (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)
9	Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit dhe lëshimi i Deklaratës Mjedisore nga MTM dhe AKM

Gjatë hartimit të Raportit të përcaktimit të çështjeve, për mbledhjen e të dhënave u zbatuan metodologjitë dhe përdorën burimet si më poshtë:

- Mbledhja e të dhënave të disponueshme të publikuara që lidhen me qëllimin e VNM-së.
- Mbledhja dhe rishikimi i të dhënave respektive nga disa raporte VNM të mëparshme, të hartuara për shpime kërkimi dhe vlerësimi në zonën e Shpiragut (kjo përfshin dokumente të VNM-ve, lejeve dhe dokumente të brendshëm të porositur nga Shell dhe jo të disponueshëm për publikun)
- Nxjerrja e të dhënave nga Raportet e Monitorimit të Mjedisit që kryen Shell-i për operacionet aktuale të shpimit dhe aplikimi i tyre në vlerësimin e ndikimeve në raportin e VNM-së.
- Zhvillimi i një sërë vrojtimesh dhe studimesh specifike në terren gjatë muajit Prill 2018 për të plotësuar mangësitë dhe përfutur të dhëna respektive për zonën, të tilla si biodiversiteti dhe habitatet, arkeologjia dhe karakteristikat sociale dhe ekonomike të zonës së projektit. Një mision i dytë u organizuar në Qershor 2018 për të vlerësuar gjendjen hidrologjike dhe hidrogjeologjike në zonën e projektit.
- Zhvillimi i konsultimit me palët e interesit si një burim i rëndësishëm informacioni gjatë VNM-së. Detaje për këto takime janë dhënë në dokumentin e Planit të Përfshirjes së Palëve të Interesit.

2. Përshkrimi i projektit

Kjo pjesë ofron një përshkrim të shkurtër të përbërësve të Projektit. Përshkrimi i dhënë pasqyron nivelin e detajeve të modelit në dispozicion në këtë fazë të zhvillimit të projektit.

2.1. Qëllimi i Projektit

Shpirag-5 është një pus vlerësues. Qëllimi i projektit është të vlerësojë rezervuarin e hidrokarburëve që pritet të gjendet ndërmjet 4,000 – 7,000 metra thellë në tokë. Gjatë vlerësimit, përcaktohet madhësia e fushës hidrokarbure dhe bëhet një përlogaritje si të zhvillohet në mënyrë më efektive për prodhimin e ardhshëm. Ky projekt ndihmon në përcaktimin nëse zhvillimi në terren mund të ketë përfitime ekonomike.

Programi i zgjeruar i vlerësimit është përshkruar në paragrafin me poshtë.

2.2. Historiku i projektit

2.2.1. Programi i zgjeruar i vlerësimit

Shpimi i pusit Shpirag-5 është pjesë e një programi më të gjerë vlerësimi për të përcaktuar nëse struktura përmban sasi ekonomike të nxjerrshme të naftës dhe gazit natyror dhe si mund të zhvillohet në mënyrë efektive.

2.2.1.1. Kërkimi dhe vlerësimi i mëparshëm

Aktivitetet kërkimore kanë nisur në vitin 2010. Gjatë periudhës 2012-2018 u shpuan puset kërkimore e vlerësues Shpirag-2, Molisht-1 dhe Shpirag-3. Aktualisht vazhdon shpimi i pusit vlerësues Shpirag-4.

Një Vlerësim i mëparshëm i Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS) për puset kërkimore Shpirag-2 dhe Molisht-1 është kryer nga Walsh Environmental Scientists and Engineers, në Nëntor të 2011. Në vijim, në Dhjetor të 2012 Walsh përfundoi Shtojcat (Shtesat) e VNMS-së për puset Shpirag-3 dhe Shpirag-4 dhe më pas, në Janar 2013, për pika alternative shpimi (shih paragrafin 1.3.2) EMA Consulting (në atë kohë e quajtur QAPM) ka marrë pjesë në këto studime.

Përpara Mars 2016 Petromanas Albania GmbH (një degë e Petromanas Energy Inc.) ishte operatori aktiv i Blloqeve 2-3 në tokë, Shqipëri, ndërsa Shell ishte partner me interes pjesëmarrjeje në KNP për këta blloqe. Në Mars 2016, Shell u bë zotëruar i vetëm interesi pjesëmarrjeje në KNP për Blloqet 2-3 dhe operator aktiv.

2.2.1.1.1. Plani aktual i Shpirag-5 dhe puset vlerësuese pasuese

Shpimi i pusit vlerësues Shpirag-5 synohet të fillojë në Q1-2022. Ky pus vlerësues do të vlerësohet në këtë proces të VNM-së. Vendimi për të shpuar puset vlerësues pasues do të bazohet në vlerësimin e pusëve Shpirag-4, Shpirag-3 dhe Shpirag-5.

Në secilin pus, do të tentohet që hidrokarburet të nxirren në sipërfaqe për të përcaktuar prodhimtarinë e mundshme të pusëve. Ky vlerësim i pusit mund të konsistojë në një periudhë të shkurtër nxjerrje disaditore, ndjekur nga një fazë vlerësimi më të zgjeruar afërsisht deri në 3 muaj (të quajtur vlerësimi afatshkurtër i pusit dhe vlerësimi i zgjeruar i pusit). Pas kësaj faze vlerësimi, puset do të pezullohen dhe do të merret një vendim nëse do të vazhdohet me Sistemin Pilot të Vlerësimit.

Nëse merret vendim për të mos e vazhduar projektin, puset do të taposen dhe braktisen dhe sheshet e pusëve do të rehabilitohen në mënyrën e duhur.

Në rast se vlerësimi fillestar i fushës së Shpiragut është i sukseshëm dhe merret një vendim për të hyrë në një fazë vlerësimi të zgjeruar, e cila mund të përfshijë Sistemin Pilot të Vlerësimit (SPV). SPV është një instalim i përmasave të vogla për të treguar potencialet afatgjata të rrjedhjes në puset vlerësues në mënyrë që të rritet siguria në performancën e mundshme të fushës përpara se të deklarohet mundësia e shfrytëzimit ekonomik të saj.

Në rast se vendimi do të jetë për të vazhduar me fazën e prodhimit të zgjeruar, atëherë puset do të taposen dhe braktisen në fund të ciklit të prodhimit ekonomik.

3. Fazat e projektit të pusit vlerësues Shpirag-5

Aktivitetet e pusit vlerësues Shpirag-5 përfshijnë:

- Përgatitja e sheshit dhe ndërtimi;
- Shpimi;
- Vlerësimi afatshkurtër dhe i zgjeruar i pusit (vlerësimi i zgjeruar vetëm në rast se vlerësimi afatshkurtër rezulton i suksesshëm), Vrojtimi për Profilizimin Sizmik Vertikal (PSV);
- Nëse rezulton i suksesshëm: Faza e përfshirjes në Sistemin Pilot të Vlerësimit (jo pjesë e këtij procesi VNM);
- Nëse rezulton i suksesshëm: Shfrytëzimi për qëllime ekonomike (jo pjesë e këtij procesi VNM);
- Nëse nuk rezulton i suksesshëm: Braktisja e pusit, çmobilizimi dhe rehabilitimi.

Secila fazë karakterizohet nga operacione me natyrë dhe madhësi të ndryshme.

3.1.1.1. Përgatitja e sheshit dhe ndërtimi

Përgatitja e sheshit dhe ndërtimi (faza përgatitore) përfshijnë operacione të tilla si: ndërtimi i rrugës (ve) të aksesit, përgatitja e sheshit (heqja e bimësisë, nivelimi, ngjeshja dhe shtrimi me çakëll), gërmimi i gropave të magazinimit dhe veshja e tyre me shtresat izoluese, ndërtimi i bazamentit ku do të vendoset koka e pusit, mobilizimi i sondës, instalimi i teknologjisë, transporti i materialeve dhe infrastruktura e furnizimit me ujë (tubacioni). Faza përgatitore zgjat afërsisht 8 muaj.

3.1.1.1. Faza e shpimit

Aktivitetet kryesore të shpimit të pusit përfshijnë: operacionet e shpimit të pusit; transportin dhe magazinimin e materialeve, karburanteve dhe ujit; menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngëta. Shpimi kërkon një sondë shpimi bashkë me ekipin, përdorimin e lëngjeve të shpimit (me bazë uji dhe nafte), karburante, veshjen me unaza çeliku dhe çimentimin e pusit, tubo çeliku dhe një burim uji.

Operacionet në zonën e shpimit do të zhvillohen 24 orë në ditë; megjithatë disa operacione (të tilla si transporti i materialeve) do të kryhen vetëm gjatë orëve me dritë natyrale. Thellësia e përgjithshme e shpimit parashikohet të variojë nga 4,000 deri në 7,000 m nën sipërfaqen e tokës (me shumë mundësi ndërmjet 5,700 dhe 7,000 metra). Periudha e shpimit parashikohet të zgjasë rreth 1 vit, por mund të zgjasë edhe 18-24 muaj. Figura 4 tregon sondën e shpimit në sheshin e pusit Shpirag-4.



Figura 1. Pamje e sondës e cila aktualisht po shpon pusin Shpirag-4.

Ekziston një mundësi që në një kohë më të vonë, në sheshin e pusit Shpirag-5 të shpohen puse të tjerë (deri në katër puse). Shpimi i puseve shtesë në të njëjtin shesh varet nga rezultatet e testit të vlerësimit dhe sukcesi i puseve të tjerë në zonë. Gjithsesi, nëse në sheshin e Shpirag-5 do të shpohen puse shtesë, kjo do të ndodhë disa vite pas shpimit të pusit të parë. Shpimi i secilit pus zgjat afërsisht 12- 18 muaj. Kohëzgjatja e ndikimeve në mjedis, sociale dhe në shëndet, që lidhen me shpimin rritet për çdo pus shtesë të shpuar. (Shënim: Puset shtesë do të jenë subjekt i një VNM-je të re)

3.1.1.2. Vlerësimi afatshkurtër dhe i zgjeruar i pusit dhe vrojtimi i profilit sizmik vertikal

Vlerësimi afatshkurtër i pusit

Pas përfundimit të shpimit/ndërrhyrjes, vlerësimi afatshkurtër i pusit do të zhvillohet për afërsisht 2 javë. Kjo kërkon pajisje dhe materiale të ndryshme nga ato të shpimit. Gjatë kësaj faze shpimi do të ndërpritet dhe do të kryhen matje të kushteve të rrjedhjes për të përcaktuar nëse është teknikisht dhe ekonomikisht e përshtatshme për shfrytëzim në të ardhmen

Pas kryerjes së matjeve dhe stimulimit të mundshëm të rezervuarit me acid (dhe/ose (shtesë) Fraksione Propanti (për tu vendosur) për të përmirësuar shkallën e rrjedhjes prej tij, për disa ditë do të zhvillohet një test vlerësimi. Nafta e prodhuar gjatë fazës së vlerësimit afatshkurtër të pusit do të magazinohet përkohësisht brenda sheshit, dhe më pas do të transportohet me autobote. Hidrokarburet e prodhuara trajtohen për të reduktuar përmbajtjen e (H₂S), nëse është në nivele të larta. Gazi natyror shoqërues do të digjet në flake. Matjet e performancës do të përcaktojnë nëse pusi mund të prodhojë sasi të mjaftueshme hidrokarburesh që garantojnë zhvillimin e vlerësimit të zgjeruar të tij.

Vlerësimi i zgjeruar i pusit

Normat e rrjedhjes afatgjatë janë shumë të pasigurta dhe varen nga karakteristikat e rezervave nëntokësore. Për pasojë, pas një vlerësimi afatshkurtër të suksesshëm, do të kryhet një vlerësim i zgjeruar për të vlerësuar performancën afatgjatë të prodhimit dhe njëkohësisht për të siguruar të dhëna hyrëse për fazën tjetër të mundshme të quajtur instalime të Sistemit Pilot të Vlerësimit, i cili nuk është pjesë e objektit të kësaj VNM-je. Pusi do të vlerësohet për një periudhë deri në 90 ditë me qëllim që të përcaktohet se si zhvillohet volumi i naftës së prodhuar (koha e rrjedhjes prej 90± ditësh mund të shpërndahet gjatë një periudhe kohore më të gjatë). Gjatë periudhës së vlerësimit të zgjeruar të pusit, nafta bruto do të transportohet nga sheshi i pusit me autobote ndërsa gazi natyror shoqërues do të digjet. Gazi sulfurik (H₂S) përsëri do të largohet nga nafta për të siguruar nivelin e lejuar për transport me autobote dhe djegien e gazit. Nëse pusi prodhon naftë në norma ekonomike, shpimi do të pezullohet përkohësisht në pritje të vendimeve rreth një sistemi vlerësimi të përkohshëm

Pezullimi nënkupton që pusi do të mbyllet përkohësisht me një tapë, e cila mund të hiqet më vonë.

Pezullimi duhet të mbyllet brenda dy viteve¹ që nga koha që pusi nuk përdoret më për qëllimin e tij origjinal. Operatorët duhet të jenë në gjendje t'i demonstrojnë Rregullatorit se integriteti i pusit po ruhet në çdo kohë para, gjatë dhe pas aktiviteteve të pezullimit të pusit.

Profilizimi sizmik vertikal

Përpara ose pas vlerësimit afatshkurtër dhe të zgjeruar të pusit, do të kryhet një vrojtim për profilizimin sizmik vertikal për të siguruar informacion shtesë për strukturën dhe vetitë e shtresave shkëmbore.

Teknika përfshin një burim i cili prodhon energji zanore në sipërfaqen e tokës dhe e dërgon nën tokë. Regjistruerit (gjeofonët) vendosen në thellësi të ndryshme në vrimën e pusit. Këta gjeofonë do të masin kohën që merr një valë zanore për të udhëtuar nga sipërfaqja e tokës në një thellësi të njohur të pusit.

¹https://www.oroogo.gov.nt.ca/sites/oroogo/files/resources/oroogo_well_suspension_and_abandonment_guidelines_and_interpretation_notes.pdf

3.1.1.3. Sistemi Pilot i Vlerësimit dhe Shfrytëzimi për qëllime ekonomike (të dy fazat nuk janë pjesë e këtij procesi VNM-je)

Nëse vlerësimi afatshkurtër dhe i zgjeruar i pusit do të rezultojnë të suksesshëm, Shell do të kërkojë aprovimin për fazën e Sistemit Pilot të Vlerësimit. Kjo është një fazë pilot e përmasave të vogla e cila do të përcaktojë nëse karakteristikat e prodhimit afatgjatë justifikojnë investimet për prodhim në shkallë të gjerë dhe për impiantet e trajtimit.

Duhet theksuar se faza e SPV nuk është pjesë e këtij procesi VNM dhe do të trajtohet në një raport të veçantë VNM, me objekt SPV. Që të justifikohet investimi për SPV duhet që disa puse (së paku dy prej tyre) të rezultojnë të suksesshëm. Prandaj faza e SPV për pusin Shpirag-5 mund të fillojë disa vite pas përfundimit të vlerësimit afatshkurtër dhe të zgjeruar të pusit. Gjatë kësaj periudhe pusi do të pezullohet (shih më lart). Në rast se sistemi pilot i vlerësimit do të rezultojë i suksesshëm, do të nisë shfrytëzimi për qëllime ekonomike i fushës naftëmbajtëse.

3.1.1.1. Braktisja e pusit, çmontimi dhe rehabilitimi

Braktisja e pusit

Nëse pusi vlerësues nuk tregon norma prodhimi tregtar të hidrokarbureve, pusi do të vuloset dhe braktiset. Kjo mund të ndodhë në fund të secilës prej fazave të përshkruara më lart. Pra, pas vlerësimit afatshkurtër të pusit, vlerësimit të zgjeruar të tij, fazës së SPV ose pas fazës së prodhimit tregtar. Procedurat që lidhen me vulosjen e pusit janë projektuar që të parandalojnë migrimin e lëngjeve ndërmjet formacioneve si dhe të parandalojnë naftën e gazin të migrojnë drejt sipërfaqes. Pusi vuloset me disa tapa çimentoje, secila më shumë se 100 metra gjatësi, të cilat vendosen në formacionet kritike në brendësi të tij. Procedura e braktisjes kërkon rreth 30-40 ditë.

Çmontimi dhe rehabilitimi i sheshit

Në përfundim të operacioneve të shpimit, sonda, pajisjet ndihmëse dhe strukturat do të largohen nga zona e shpimit. Nëse është e nevojshme, gryka e pusit do të mbushet. Pas braktisjes së pusit, sheshi i pusit dhe strukturave ndihmëse do të kthehet sa më shumë të jetë e mundur në gjendjen e mëparshme (të kthehet në tokë bujqësore) sipas një Plani të detajuar të Braktisjes dhe Rehabilitimit i cili do të hartohet dhe diskutohet me autoritetet dhe komunitetet përpara braktisjes. Çmontimi do të zgjasë afërsisht 30± ditë ndërsa rehabilitimi i zonës rreth 5 – 12 muaj².

Fazat e projektit Shpirag-5, ndërvarësia e tyre dhe kohëzgjatja e përafërt janë treguar të përmbledhura në Tabela 1.

Tabela 1. Përmbledhje e fazave të pusit vlerësues Shpirag-5

Fazat e projektit	Vërejtje	Kohëzgjatja e përafërt	Alternativa Shpirag-5 Vlerësimi i pusit D dhe bllokut të pusit C
1. Përgatitja e sheshit dhe ndërtimi	-	8 muaj	Përfshihet në objektin e amendimit të VNM-së.
2. Faza e shpimit	-	12-24± muaj për pus	Përfshihet në objektin e amendimit të VNM-së.
3. Vlerësimi afatshkurtër dhe i zgjeruar i pusit dhe Vrojtimi për	Vlerësimi i zgjeruar i pusit zbatohet	2 javë + deri në 90± ditë VSP 1-3	Përfshihet në objektin e amendimit të VNM-

² Plani i Braktisjes dhe Rehabilitimit (PBR) që do të hartohet brenda 8 muajve pas lëshimit të Lejes Mjedisore, do të specifikojë kohën e nevojshme për braktisjen dhe aktivitetet e rehabilitimit. Sipas detyrimeve ligjore, PBR do të miratohet nga Autoritetet dhe do të azhurnohet çdo 3 vjet.

Fazat e projektit	Vërejtje	Kohëzgjatja e përfaqëruar	Alternativa Shpirag-5 Vlerësimi i pusit D dhe bllokut të pusit C
profilizimin sizmik vertikal (PSV)	vetëm nëse vlerësimi afatshkurtër është i suksesshëm	ditë	së.
4. Faza e Sistemit Pilot të Vlerësimit	Zbatohet vetëm nëse vlerësimet e pusit janë të suksesshme	2-5 vjet	Nuk përfshihet në objektin e amendim VNM-së.
5. Faza e prodhimit ekonomik	Zbatohet vetëm nëse SPV është i suksesshëm.	Deri në 35 vjet	Nuk përfshihet në objektin e amendim VNM-së.
6. Braktisja e pusit, çmontimi dhe rehabilitimi	-	6 muaj	Përfshihet në objektin e amendimit të VNM-së.

3.2. Vendndodhja e Projektit

Vendndodhja e pusit për Shpirag-5 D u studiua në Amendimin e VNM-se-s e cila mori deklaratën Mjedisore në Shkurt 2021.

Një tubacion uji mund të ndërtohet nga sheshi i pusit deri në rezervuarin e Mbreshtanit




Figure 2. Hartë Topografike e Vendndodhjeve Alternative të Pusit të Shpirag -5 (D)

Përzgjedhja përfundimtare e vendndodhjes së pusit do të bazohet në disa kritere të ndryshme:

- Vendndodhja e rezervuarit në sipërfaqe
- Aftësia për të shpuar dhe depërtuar në vendin e parashikuar të rezervuarit
- Përshtatshmëria e vendit për ndërtime civile (përfshirë koston e ndërtimit)
- Ndikimi në mjedis i ndërtimit të jastëkut dhe pusit
- Ndikimi në popullatën lokale në faktorë të tillë si emetimet gjatë testimit të puseve.

Rrugët e reja dhe të përmirësuara të aksesit do të kenë një gjerësi prej 8 m. Për vendndodhjen alternative të pusit D do të kërkohen 125 metra rrugë e re hyrëse dhe 77 metra rrugë pritjet të modernizohen.

Sheshi i pusit kërkon një shesh me sipërfaqe prej 43,840 m² për alternativën D.




Figure 3. Vendodhja e sheshit të pusit Shpirag-5, alternative D.³

Koordinatat e vendodhjes së pusit dhe zonës së afërt përreth tij dhe rrugëve të reja të hyrjes janë dhënë në Tabelën më poshtë.

Table 2. Kordinatat e Vendodhjes së Alternativës D të pusit Shpirag-5

No	Albania 1987 GK Zone 4		WGS1984 UTM Zone 34N		ETRS 1989 Albania 2010	
	X	Y	X	Y	X	Y
1	4403980.4	4512634.079	403888.1442	4510698.364	488313.9071	4511889.476
2	4403948.609	4512590.972	403856.3655	4510655.275	488282.6123	4511846.015
3	4403909.434	4512583.974	403817.2066	4510648.279	488243.5243	4511838.572

³ Raporti i VNMS-së për pusin Shpirag-5 në Berat, Blloku 2-3 Shqipëri / kryer nga Royal HaskoningDHV Company HASKONINGDHV NEDERLAND B.V. 27 -08- 2019.

No	Albania 1987 GK Zone 4		WGS1984 UTM Zone 34N		ETRS 1989 Albania 2010	
	X	Y	X	Y	X	Y
4	4403847.315	4512624.471	403755.1133	4510688.76	488180.9559	4511878.355
5	4403776.623	4512663.396	403684.4498	4510727.669	488109.8333	4511916.466
6	4403764.628	4512641.211	403672.4599	4510705.493	488098.0934	4511894.149
7	4403723.483	4512619.279	403631.3315	4510683.57	488057.2057	4511871.752
8	4403693.122	4512640.133	403600.9826	4510704.415	488026.6125	4511892.257
9	4403721.642	4512681.496	403629.4909	4510745.762	488054.656	4511933.937
10	4403748.503	4512734.771	403656.3414	4510799.015	488080.9057	4511987.509
11	4403750.718	4512774.382	403658.5556	4510838.61	488082.6692	4512027.137
12	4403754.703	4512803.349	403662.5384	4510867.565	488086.3229	4512056.145
13	4403752.325	4512823.978	403660.1613	4510888.186	488083.7103	4512076.742
14	4403751.518	4512843.188	403659.355	4510907.388	488082.685	4512095.94
15	4403752.517	4512866.48	403660.3536	4510930.67	488083.4185	4512119.239
16	4403754.943	4512872.408	403662.7784	4510936.595	488085.7763	4512125.193
17	4403755.638	4512873.817	403663.4732	4510938.004	488086.4552	4512126.609
18	4403756.423	4512875.067	403664.2583	4510939.254	488087.2263	4512127.869
19	4403757.391	4512876.303	403665.2255	4510940.489	488088.1796	4512129.115
20	4403758.414	4512877.367	403666.2484	4510941.553	488089.1906	4512130.191
21	4403759.612	4512878.382	403667.4452	4510942.567	488090.3761	4512131.219
22	4403762.86	4512880.776	403670.6927	4510944.96	488093.5971	4512133.65
23	4403766.765	4512883.772	403674.5961	4510947.955	488097.4672	4512136.69
24	4403768.458	4512885	403676.2876	4510949.183	488099.1451	4512137.937
25	4403770.351	4512886.076	403678.1801	4510950.258	488101.0258	4512139.034
26	4403776.347	4512888.483	403684.1737	4510952.664	488106.9933	4512141.509
27	4403782.032	4512889.769	403689.8564	4510953.95	488112.6626	4512142.86
28	4403784.317	4512890.224	403692.1409	4510954.404	488114.9424	4512143.34
29	4403785.767	4512890.359	403693.5899	4510954.539	488116.3902	4512143.492
30	4403788.113	4512890.335	403695.9346	4510954.516	488118.7357	4512143.495
31	4403789.975	4512890.108	403697.796	4510954.288	488120.6001	4512143.289
32	4403792.396	4512889.519	403700.2164	4510953.7	488123.0278	4512142.728
33	4403804.706	4512885.914	403712.5214	4510950.096	488135.3766	4512139.263
34	4403822.669	4512875.837	403730.4773	4510940.023	488153.4512	4512129.393
35	4403842.652	4512860.773	403750.4513	4510924.965	488173.6013	4512114.559
36	4403864.768	4512849.659	403772.5589	4510913.856	488195.8404	4512103.699

No	Albania 1987 GK Zone 4		WGS1984 UTM Zone 34N		ETRS 1989 Albania 2010	
	X	Y	X	Y	X	Y
37	4403879.597	4512846.914	403787.3821	4510911.112	488210.6982	4512101.124
38	4403891.83	4512842.433	403799.6101	4510906.633	488222.98	4512096.783
39	4403898.083	4512839.609	403805.8606	4510903.81	488229.264	4512094.031
40	4403906.688	4512834.036	403814.4621	4510898.24	488237.9309	4512088.557
41	4403911.431	4512829.92	403819.2023	4510894.125	488242.7191	4512084.495
42	4403922.885	4512818.542	403830.6523	4510882.752	488254.3012	4512073.25
43	4403937.899	4512798.797	403845.6604	4510863.014	488269.5376	4512053.679
44	4403963.787	4512776.59	403871.5376	4510840.817	488295.6735	4512031.771
45	4403988.943	4512738.17	403896.683	4510802.413	488321.2621	4511993.645
46	4404028.964	4512686.883	403936.6875	4510751.147	488361.8597	4511942.824
47	4404038.01	4512679.535	403945.7305	4510743.802	488370.9884	4511935.581
48	4404048.092	4512670.798	403955.8077	4510735.068	488381.1674	4511926.96
49	4404058.164	4512663.494	403965.8755	4510727.768	488391.3207	4511919.772
50	4404099.055	4512636.486	404006.7499	4510700.77	488432.5118	4511893.235
51	4404097.975	4512633.036	404005.6703	4510697.321	488431.4713	4511889.773
52	4404094.391	4512627.61	404002.088	4510691.898	488427.95	4511884.307
53	4404089.964	4512622.531	403997.663	4510686.821	488423.5818	4511879.179
54	4404049.055	4512606.008	403956.771	4510670.304	488382.8689	4511862.192
55	4404018.235	4512604.802	403925.9638	4510669.099	488352.0686	4511860.636

Zona e projektit dhe zona e ndikimit

Pjesë e procesit të VNM-së është të përcaktojë ndikimet e mundshme në mjedis, sociale dhe në shëndet për vendndodhjet e reja alternative siç është përcaktuar dhe vlerësuar për alternativat e mëparshme të Projektit. Me qëllim që të vlerësohen si duhet këto ndikime në mjedis, sociale dhe në shëndet, është përcaktuar një zonë më e gjerë e projektit.

Duke ndjekur metodologjinë e VNMS kryesore, Zona aktuale e Ndikimit (Aol) vlerësohet për secilin ndikim në këtë VNMS dhe është zakonisht një zonë më e vogël se zona e ndikimit të mundshëm. Zona e ndikimit përcakton zonën e studimit për receptorë të ndryshëm.

Madhësia e zonës së Projektit ndryshon për receptorë të ndryshëm:

- Ndikimet e mundshme në tokë janë konsideruar vetëm brenda shesheve të mundshëm të pusit dhe zonën ngjitur me to.
- Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësorë, ujërat sipërfaqësorë, biodiversitet, ajër dhe shëndet janë marrë në konsideratë brenda një rrezeje 1,000 metra nga dy sheshet alternative të pusit.
- Ndikimet e mundshme në lidhje me aspektet sociale dhe monumentet e trashëgimisë kulturore janë konsideruar kryesisht brenda një rrezeje 2,000 metra nga të dy sheshet alternative të pusit. Duhet vënë në dukje se ndikime të caktuara sociale, dhe veçanërisht ndikimet pozitive, mund të ndodhin jashtë kësaj zone të projektit.

- Ndikimet e mundshme që lidhen me rrugët e aksesit janë konsideruar deri në 200 m në secilën anë të rrugës. Ndikimet e lidhura me trafikun janë konsideruar përgjatë rrugës nga sheshi i pusit deri në pikën ku ky trafik përfshihet në trafikun e zakonshëm. Kjo është deri në pikën ku trafiku arrin rrugën kryesore SH72 në Urën Vajguore.

Zonat e projektit për të dy vendodhjet e mundshme për sheshin e pusit Shpirag-5 janë treguar në hartë topografike të një rajoni më të gjerë.

4. Analiza e alternativave të marra në shqyrtim

Në VNM-në e përgatitur nga Royal Haskoning DHV që ka marrë deklaratën Mjedisore me 25 Nëntor 2019 janë konsideruar alternativat A dhe B. Sidoqoftë, duke u bazuar në ndryshimet teknike dhe përparësitë shoqëruese, u gjykua e nevojshme të studionte Ndikimin Mjedisor dhe Social të Padeve Alternative të Puseve C & D, i cili është aprovuar më 17.02.2021. Kompania ka vendosur të aplikojë për Leje Mjedisori për pusin me vendodhje në alternativën D.

Studimi për naftën është një proces i kushtueshëm dhe teknologjikisht kompleks me një rezultat të pasigurt, sepse jo të gjitha sondazhet sizmike çojnë në zbulimin e hidrokarbureve, zhvillimin dhe prodhimin. Një analizë e alternativave të disponueshme është e nevojshme për të vendosur realizueshmërinë e hartimit të projektit dhe për të siguruar që opsionet më të përshtatshme të menaxhimit dhe teknologjisë do të miratohen për projektin. Përshtatshmëria e alternativave mund të ndryshojë midis kushteve të ndryshme mjedisore dhe ekonomike

Studimet desktop mbi gjeologjinë nën sipërfaqe informojnë vendimet për të eksploruar zona që mund të kenë potencial për rezerva të naftës. Sondazhet sizmike ofrojnë të dhëna me detaje dhe cilësi të mjaftueshme, të tilla që ekspertët gjeofizikë mund të përcaktojnë nëse duhet të bëhet një investim për pusët e kërkimit dhe vlerësimit. Studimi sismik është i nevojshëm për të identifikuar vendet me premtimin më të madh për pusët e kërkimit, vlerësimit dhe zhvillimit në të ardhmen.

Figura më poshtë jep një përmbledhje të zonës ku synohet të vendoset zona e pusit Shpirag-5, duke treguar dhe vendet e tjera të puseve të konsideruara dhe zona përreth duke përfshirë fshatrat / qytetet përreth, rezervuarin e ujit dhe Shpirag-2/4 dhe Shpirag- 3 puseta pasi dhe kampi ekzistues.




Figure 4. Harta topografike me vendet e propozuara dhe pusët ekzistuese

5. Të dhëna për gjendjen bazë të mjedisit

5.1. Hyrje

Në këtë pjesë Konsultenti paraqet një përshkrim të mjedisit aktual bazuar tek të dhënat ekzistuese dhe informacionin që gjendet në raportin kryesor të VNMS-së. Studimi u thellua më tej me të dhëna nga studime shtesë dhe vërtetimet në terren, të cilat u mbledhën dhe u analizuan gjatë inspektimeve të kryer në terren, duke u fokusuar tek zonat e propozuara për sheshin e pusit Shpirag 5. Vërtetimi përfshin aspektet përkatëse të mjedisit fizik dhe natyror dhe kushtet social-ekonomike të zonave të që mund të ndikohen nga projekti, duke përfshirë klimën, gjeomorfologjinë dhe gjeologjinë, burimet ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore), burimet biologjike dhe ekologjike (florën, faunën, diversitetin e specieve të mbrojtura, habitatet kritike, ekosistemet), peizazhin dhe imazhin pamor, cilësinë e ajrit, zhurmën, çështjet sociale dhe social-ekonomike, sigurinë dhe shëndetin në punë, përdorimin e tokës dhe modelet e qendrave të banuara, trashëgiminë kulturore, etj.

5.2. Mjedi Fizik

Zona e propozuar për sheshin e pusit Shpirag-5 gjendet në pjesën lindore të Zonës së Klimës Mesdhetare Fushore. Në të bien reshje të bollshme gjatë vjeshtës dhe dimrit, kryesisht në formë shiu. Karakteristikë fizike e shesheve të propozuar të pusit dhe rrugëve të aksesit është terreni kodrinoro-malor me malin e Shpiragut në lindje (me një lartësi afërsisht 300 m).

Zona e pusit të Shpirag 5 gjendet në një strukturë antiklinale të nënzonës së Dimalit, që i përket brezit të rrudhosur mbulesor Jonian.

Depozitimet më të vjetra që dalin në sipërfaqe në këtë rajon janë të Kretakut të sipërm (Cr2), dhe përbëjnë krahët dhe kreshtat e strukturave të palosjes. Këto shtresa janë depozituar njëpasnjëshëm në depozitat e Kretakut të Ulët. Një horizont gëlqerorësh fosfatik gjendet në dyshtemenë e prerjes, i cili përbëhet nga shtresa të holla të gëlqerorëve mikritikë, me ngjyrë të bardhë në gri, me teksturë brezore dhe me

alternime shtresash të holla e të rralla silicore. Ndjeshmëria e tokës është më e ulët se ajo e zonave natyrore për sa i përket funksioneve të ekosistemit, por është e ngjashme për sa i përket sigurimit, strukturës së tokës dhe cilësisë së tokës. Në zonën e projektit Shpirag-5 ka dy tipe tokash: Calcaric regosols dhe Shkëmbi parësor – gëlqeror.

Këto mund të përshkruhen si toka pjellore, të përshtatshme për një gamë të gjerë përdorimesh bujqësore. Aktualisht tokat në zonën e projektit karakterizohen nga përdorimi antropogjenik. Ndjeshmëria e tyre është më e vogël se ajo e tokave natyrore në lidhje me funksionet e ekosistemit, por është thuajse e njëjtë në terma të kushteve, strukturës së tokës dhe cilësisë së tokës.

Brenda zonës së projektit kalon një rrjedhë sezonale e cila shërben edhe si kanal kullues për tokat bujqësore. Rrjedha ka ujë vetëm disa muaj në vit. Brenda zonës së projektit nuk ka rrjedha të përhershme ujore. Akuiferët nëntokësorë kanë një prodhimtari mesatare. Sasia e disponueshme e ujit sipërfaqësor dhe, në një masë më të vogël, sasia e ujërave nëntokësore, zvogëlohet ndjeshëm gjatë verës.

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit pranë zonës së projektit janë karrierat gëlqerore dhe aktivitetet e minierave të hapura gëlqerore, të vendosura pranë fshatrave Konisbaltë dhe Pashalli. Këto aktivitete gjenerojnë pluhur të konsiderueshëm (grimcat e Ngurta në Ajër, PM) dhe zhurmë. Ndotja e ajrit nga trafiku i automjeteve aktualisht është e pa matur. Gjendja e dobët e rrugëve, veçanërisht në zonat rurale, krijon sasi të mëdha pluhuri gjatë lëvizjes së mjeteve, veçanërisht në periudhat e thata (muajt e verës).

5.3. Biodiversiteti dhe habitatet

Në zonën e projektit të Shpirag-5 dhe veçanërisht në shpatet kodrinore, gjendet një gamë e gjerë habitatesh duke filluar nga pyjet me pisha mesdhetare dhe zonat ku mbizotërojnë shkurre të parashkretëtirës të degraduara deri në sipërfaqe të vogla tokash bujqësore. Zona e parapëlqyer e pusit gjendet në habitatin “sipërfaqe të vogla tokash bujqësore”.

Disa nga llojet bimore kanë vlerë shkencore dhe përfshihen në grupin e llojeve me interes kombëtar ruajtjeje, si p.sh. *Salvia officinalis*, *Hypericum perforatum*, *Juniperus oxycedrus*, *Origanum vulgare*, *Sambucus nigra*, *Satureja Montana*. Gjithsesi këto bimë mund të takohen vetëm në zonat kodrinore, relativisht larg zonës së parapëlqyer të pusit. Në zonën e parapëlqyer të pusit nuk janë regjistruar lloje të rrezikuar dhe/ose kërcënuar bimësh.

Fauna e gjitarëve ka popullsi të ulët dhe shumëllojshmëri relativisht të varfër të specieve sepse shumica e zonës së studimit është e dominuar nga habitatet bujqësore dhe të modifikuara rurale të bujqësisë dhe ekosisteme shkurre të degraduara. Disa prej këtyre llojeve përdorin sheshet e propozuara të shpimit për ushqim dhe disa prej tyre për të jetuar atje (zvarranikët, lloje amfibësh ose vertebrorësh). Asnjë nga gjitarët që gjenden në një territor të gjerë përreth zonës së projektit (më së shumti në kodra) nuk është i kërcënuar globalisht dhe të gjitha llojet që pritet të jenë të pranishme në zonën e projektit (më së shumti në kodra) konsiderohen të rrezikuara.

Në total, 19 lloje kërcënohen në nivel kombëtar, duke përfshirë 4 gjitarë, 12 shpendë, 2 zvarranikë dhe 1 lloj amfib. Asnjë nga speciet e faunës së rrezikuar dhe të kërcënuar në nivel kombëtar nuk jeton brenda shesheve të propozuara të shpimit, por disa prej tyre, siç janë zogjtë grabitqarë (*Buteo buteo*, *Falco tinnunculus*, *Accipiter nisus*), qelbësi (*Mustela putorius*) dhe baldosa (*Meles meles*), përdorin zonën si pjesë të terrenit të tyre për ushqim.

Nuk ka zona të mbrojtura dhe monumente natyrore brenda ose pranë/përreth zonës së projektit Shpirag - 5. Zona e ndikuar direkt është e vendosur në tokë private. Në afërsi të shesheve të propozuara nuk ka pyje dhe kullota, të cilat janë në pronësi të bashkisë.

Megjithatë, meqenëse disa nga llojet e përmendur më sipër i përdorin zonat e pusit për ushqim ose jetesë, mund të shfaqen ndikime veçanërisht lidhur me përgatitjen e zonës së shpimit.

5.4. Gjendja e mjedisit socio – ekonomik dhe shëndetit

Fshati Konisbaltë ku gjendet zona e preferuar e shpimit dhe fshati më i afërt Pashalli janë pjesë e Njësisë administrative Ura Vajgurore (së bashku me qytetin e Urës Vajgurore dhe fshatrat Bistrovicë, Vokopolë dhe Skrevan). Njësia administrative Ura Vajgurore është një ndër katër njësitë administrative të Bashkisë Ura Vajgurore së bashku me Poshnjen, Kutallinë dhe Cukalatin, përfshirë në Qarkun e Beratit.

Sipas Census-it të vitit 2011 Bashkia e Urës Vajgurore, me një sipërfaqe prej prej 156.56 km², ka një popullsi prej 27,295 banorësh me densitet 174 banorë/km². Bazuar në Regjistrin e Gjendjes Civile fshati Konisbaltë ka 805 banorë, 70% e të cilëve ortodoksë dhe 30% muslimanë. Në fshatin Konisbaltë është i pranishëm një komunitet nga minoriteti Arumun. Në Konisbaltë nuk ka objekte të besimit fetar dhe në të gjithë zonjën e projektit nuk ka konflikte për shkak të besimit.

Aksesi në shkollimin fillor në zonën e projektit është i mirë pasi të gjithë fshatrat kanë shkolla fillore nga klasa e parë në të katërt. Fshatrat Mbreshtan, Konisbaltë dhe Pashalli kanë qendra shëndetësore ku ofrohet kujdesi parësor. Shërbime shëndetësore më të specializuara dhe farmaci gjenden në qytetin e Beratit dhe Urës Vajgurore, respektivisht në largësi 7km dhe 4km nga këta fshatra.

Zona e Shpirag-5 është e njohur për karrierat sipërfaqësore të gurit dhe së fundmi edhe për përpunimin e graniteve dhe gëlqeres. Zona njihet ndryshe edhe si “karriera” e Shqipërisë për shkak të numrit të madh të kompanive private që zhvillojnë këtë lloj aktiviteti në këtë zonë, veçanërisht në Konisbaltë dhe Pashalli. Aktivitetet minerare të gurorëve ofrojnë mundësi punësimi për komunitetin por dhe ndotje të madhe me pluhur, trafik të rënduar, çlirime zhurmash dhe ndikime negative në pejsazhin e zonës..

Në Konisbaltë banorët mbajnë bagëti (dele, dhi dhe lopë) kryesisht për konsum familjar ndërsa tepricat e prodhimit mund të shiten. Në periferi të fshatit, pranë shesheve të propozuar të pusit gjenden dy bletërritës të cilët shfrytëzojnë tokat përfshirë sheshet e propozuar për pusin, për të prodhuar mjaltë. Në fshatin Pashalli janë pak familje që mbajnë një numër të konsiderueshëm bagëtish, kryesisht dhen. Nga një intervistë me kryetarin e fshatit u mësua se kamionët përbëjnë rrezik për tufat e bagëtive. Prodhimi bujqësor në fshatrat pranë Shpirag-2/4 është përmirësuar vitet e fundit në sajë të rritjes së pemëve frutore. Megjithatë ngastrat me sipërfaqe të vogël e bëjnë të vështirë mekanizimin dhe marrjen e kreative. Për këtë arsye investimet në teknologji janë të kufizuara dhe reduktojnë efikasitetin dhe fitimet. Përmirësimi i sistemit të ujitjes është një shqetësim i madh i cituar nga banorët e interesuar për përmirësimin e prodhimit bujqësor. Në zonën e projektit, fermerët kultivojnë kryesisht ullinj dhe pemë frutore, ndërkohë që ka ara me misër dhe grurë për konsum shtëpiak. Fshatarët gjithashtu kultivojnë lakra, presh, tërshërë, joxhë, bar, bajame, qersh, domate dhe specat.⁴

Asnjë gjurmë e dukshme arkeologjike nuk u identifikua pranë puseve të propozuara të puseve ose rrugëve të reja / të azhurnuara të hyrjes për Shpirag-5, gjatë Sondazhit të Trashëgimisë Arkeologjike dhe Kulturore.

6. Analiza e ndikimeve të mundshme në mjedis

6.1. Metodologjia e vlerësimit të ndikimit

Në përgatitjen e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social, Konsulenti ka përdorur njohuritë, eksperiencën dhe metodologjinë më të mirë për të identifikuar dhe përpiluar të dhënat teknike dhe informacionin në dispozicion, duke shfrytëzuar burimet parësore dhe dytësore të të dhënave. Supozimet e duhura dhe të arsyeshme inxhinierike / të bazuara shkencërisht, janë bërë për të mbuluar çdo informacion ose boshllëk të të dhënave. Gjatë përgatitjes së Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social, Konsulenti është siguruar të jetë në përputhje me:

⁴ Intervistat të zhvilluara me fshatarët nga fshatrat Mbreshtan, Konesbaltë dhe Pashalli 10-12 Prill 2018.

- Rregulloret dhe standardet aktuale mjedisore dhe sociale në Shqipëri
- Standardet e Performancës dhe udhëzimet e KFN-së.
- Standartet dhe manualin për aspektet mjedisore, sociale dhe shëndetësore të Shell (HSSE&SP CF) që bazohet në standartet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis i projektit të propozuar është një qasje që kombinon **Shkallën (Madhësinë) e Ndikimit** dhe **Ndjeshmërinë e Receptorit** për të përcaktuar **Rëndësinë e Ndikimit**. Metodologjia përcakton dhe vlerëson ndikimet e mundshme të Projektit të Propozuar siç përshkruhen në figurën më poshtë.



Figura 2. Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Hapi i parë i metodologjisë së vlerësimit mjedisor është parashikimi i ndikimeve të mundshme që lidhen me aktivitetet e projektit. Ky hap përfshin një parashikim të asaj që ka të ngjarë të ndodhë me burimet mjedisore dhe receptorët socialë për shkak të ndërtimit, funksionimit dhe çaktivizimit të projektit.

Hapi i dytë konsiston në vlerësimin e ndikimeve të parashikuara. Ndikimet mjedisore dhe sociale mund të jenë të natyrës, llojit dhe shtrirjes së ndryshme. Në varësi të kushteve ekzistuese të mjedisit dhe ndërveprimit me aktivitetet e projektit, efektet e ndikimit mund të jenë të drejtpërdrejta, indirekte, të induktuara ose kumulative. Për këtë VNMS shtesë, teknikat cilësore dhe sasiore për klasifikimin e ndikimeve tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 2. Karakteristikat e ndikimeve

Karakteristika	Përcaktimi
Natyra	Pozitive; Negative.
Lloji	Drejtpërdrejtë; Indirekt; I Induktuar; Kumulativ.
Shtrirja	Lokal; Rajonal; Ndërkufitar; Ndërkufitar.
Kohëzgjatja	E përkohshme; Afatshkurtër; Afatgjatë; E përhershme.
Shkalla	Nuk ka përcaktime fikse për këtë karakteristikë.
Frekuenca	Nuk ka përcaktime fikse për këtë karakteristikë.

Pasi karakteristikat e ndikimit të jenë të qarta dhe të kuptuara, karakteristikat e mësipërme do të përdoren për t'i caktuar secilës ndikim një madhësi/shkallë. Madhësia është një kombinim dhe funksion i karakteristikave të mëposhtme të ndikimit:

- Shtrirja;
- Kohëzgjatja;
- Shkalla, Frekuenca; dhe,
- Probabiliteti që do të ndodhë impakti.

Në thelb, madhësia përshkruan shkallën e ndryshimit që ndikimi ka të ngjarë të shkaktojë në burim apo receptor. Ashtu si në rastin e shtrirjes dhe kohëzgjatjes, vetë përcaktimet e madhësive përdoren në të gjithë botën dhe në të gjithë burimet / receptorët, por përkufizimet për këto përcaktime do të ndryshojnë bazuar në një burim / receptor, siç diskutohet më poshtë. Përcaktimet universale të madhësisë janë:

- Ndikim pozitiv;
- Ndikim i papërfillshëm;
- Ndikim negativ i vogël;
- Ndikim negativ i mesëm;
- Ndikim negativ i madh.

Përveç karakterizimit të madhësisë së ndikimit, hapi tjetër kryesor i nevojshëm për të caktuar rëndësinë e një ndikimi të caktuar është përcaktimi i ndjeshmërisë ose rëndësisë (vlera) së burimit / receptorit të ndikuar. Ashtu si në rastin e madhësisë, përcaktimet e ndjeshmërisë / rëndësisë në vetvete janë në përputhje të përgjithshme, por përkufizimet për këto përcaktime do të ndryshojnë bazuar në një burim / receptor. Përcaktimet universale të ndjeshmërisë / vulnerabilitetit/ rëndësisë janë:

- I ulët;
- I mesëm; dhe,
- I lartë.

Për sa i përket shkallës së madhësisë, përkufizimi për çdo përcaktim ndryshon në varësi të burimit/receptorit. Kur burimi është fizik (për shembull, një trup ujqor) merren parasysh cilësia e tij, ndjeshmëria për të ndryshuar, dhe rëndësia (në shkallë lokale, kombëtare, ndër-kufitare dhe ndërkombëtare). Kur burimi/receptorit është biologjik ose kulturor, merren parasysh rëndësia (lokale, ndërkufitare, kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe ndjeshmëria e tij në lidhje me llojin specifik të ndikimit. Kur receptorit është njerëzor, merren parasysh çënueshmëria e individit, komunitetit apo e grupit shoqëror më gjerësisht.

Kur madhësia e ndikimit dhe ndjeshmëria / rëndësia e burimit ose receptorit janë karakterizuar, mund të caktohet rëndësia për secilin ndikim. Për vlerësimin e kësaj VNMS-je do të zbatohen kategoritë e mëposhtme për vlerësimin e rëndësisë së ndikimit:

- Ndikim pozitiv;
- me rëndësi të papërfillshëm;
- me rëndësi të ulët;
- m rëndësi të mesme; dhe,
- me rëndësi të madhe.

Për më tepër, rëndësia e ndikimit kategorizohet duke përdorur matricën e treguar në tabelën më poshtë.

Tabela 3. Matrica mbi Rëndësinë e Ndikimit

		Ndjeshmëria/Cënueshmëria/Rëndësia e Burimit/Receptorit		
		E ulët	E mesme	E lartë
Madhësia	E papërfillshme	E papërfillshme	E papërfillshme	E papërfillshme
	E vogël	E papërfillshme	E vogël	E mesme

		Ndjeshmëria/Cënueshmëria/Rëndësia e Burimit/Receptorit		
		E ulët	E mesme	E lartë
ndikimeve	E mesme	E vogël	E mesme	E madhe
	E madhe	E mesme	E madhe	E madhe

Matrica zbatohet në mënyrë universale për të gjitha burimet / receptorët, dhe të gjithë ndikimet në këto burime / receptorë, pasi burimet / receptorët ose përcaktimet specifike të ndikimit janë faktorizuar në caktimin e madhësive dhe përcaktimeve të ndjeshmërisë që regjistrohen në matricë. Kutia 1 më poshtë paraqet një kontekst për atë që tregojnë vlerësimet e ndryshme të rëndësisë së ndikimit.

Kutia 1. Konteksti për atë që tregojnë vlerësimet e ndryshme të rëndësisë së ndikimit

Një ndikim **merëndësi të papërfillshme** do të thotë kur një burim / receptor (përfshirë njerëzit) në thelb nuk do të ndikohet në asnjë mënyrë nga një aktivitet i veçantë ose efekti i parashikuar, vlerësohet të jetë "i padukshëm" ose nuk dallohet nga ndryshimet e sfondit natyror.

Një ndikim me **rëndësi të vogël** do të thotë kur një burim / receptor do të përjetojë një efekt të dukshëm, por madhësia e ndikimit është mjaft e vogël (me ose pa zbutje) dhe / ose burimi / receptor është me ndjeshmëri / cënueshmëri/ rëndësi të ulët. Në secilin rast, madhësia duhet të jetë brenda standardeve të zbatueshme.

Një ndikim me **rëndësi të moderuar** ka një shkallë ndikimi që është brenda standardeve të zbatueshme, por klasifikohet në intervalin midis pragut nën të cilin ndikimi është i vogël, deri në një nivel që mund të jetë gati për të shkelur një kufi ligjor. Është e qartë se të hartosh një aktivitet në mënyrë që efektet e tij të shmangin vetëm thyerjen e një ligji dhe / ose të shkaktojnë një ndikim të madh nuk është praktika më e mirë. Theksi për ndikimet e moderuara është për të demonstruar që ndikimi është zvogëluar në një nivel sa më të ulët të mundshëm (ALARP). Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht që ndikimet me rëndësi të moderuar duhet të reduktohen në të vogla, por që ndikimet e moderuara po menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase.

Një ndikim me **rëndësi të madh** do të thotë kur kufiri ose standardi i pranuar mund të tejkalohet, ose kur ndikimet në shkallë të madhe ndodhin tek burime të ndjeshme/ receptor shumë të rëndësishëm. Një synim i vlerësimit të ndikimit është të arrijë një pikë ku Projekti nuk ka ndonjë ndikim të madh të mbetur, veçanërisht jo ndikime që do të zgjasin për një kohë të gjatë apo do të përfshijnë një zonë të gjerë. Sidoqoftë, për disa aspekte mund të ketë ndikime të mëdha të mbetura pasi të jenë shteruar të gjitha opsionet praktike të zbutjes (d.m.th. është aplikuar ALARP). Një shembull mund të jetë ndikimi vizual i një strukture. Për të marrë një vendim të tillë për Projektin i takon institucioneve rregullatore dhe palëve të interesit për të peshuar faktorët negativ kundrejt atyre pozitivë, si për shembull punësimi.

Hapi i tretë i metodologjisë së vlerësimit është përcaktimi i masave zbutëse përkatëse. Ky konsiderohet një komponent kyç i procesit të VNM-së i cili shqyrton mënyrat praktike të shmangjes ose reduktimit të ndikimeve të rëndësishme të mundshme të projektit të propozuar. Më pas, masat zbutëse të identifikuara paraqiten si detyrime në Projektin e propozuar. Qëllimi i zbutjes është të parandalojë ose menaxhojë ndikime negative të rëndësishme dhe ti ulë ato në një nivel sa më të ulët të mundshëm (ALARP)⁵si dhe të optimizojë dhe maksimizojë çdo përfitim të mundshëm të Projektit, kur është e mundur. Për këtë VNMS, zbutja do të synojë të sigurojë që, kudo që është e mundur, ndikimet e mundshme të zbuten në burim sesa të zbuten përmes restaurimit pasi të ketë ndodhur ndikimi.

⁵Në nivelet më të Ulta të Mundura (ALARP) është pika në të cilën kostoja dhe përpjekja (koha dhe telashet) e zvogëlimit të mëtejshëm të rrezikut janë jashtëzakonisht joproporcionale me uljen e rrezikut të arritur.

Hapi i katërt i metodologjisë së vlerësimit është të rivlerësojë ndikimet që mbeten pas zbatimit të masave zbutëse. Këto ndikime zakonisht njihen si ndikime të mbetura. Meqenëse masat zbutëse do të zbatohen për të zvogëluar ndikimet në ALARP, ato nuk mund të eliminohen plotësisht. Është e rëndësishme të kuptohet rëndësia e këtyre ndikimeve të mbetura në mënyrë që të përcaktohen disa forma të monitorimit ose matjes për t'i kontrolluar ato.

6.2. Identifikimi i Ndikimeve potenciale të Projektit

Në VNM janë identifikuar dhe vlerësuar të gjitha ndikimet për projektin e propozuar. Paragrafi 5.2.4 i VNM-s përshkruan të gjitha masat standarde që zbatohen nga Shell / SUA për të parandaluar ose zbutur këto ndikime të mundshme. Ndikimet (duke marrë parasysh masat standarde) vlerësohen në vlerësimin e ndikimit dhe paraqiten në paragrafin 5.2.5. Për më tepër, ky kapitull identifikon dhe vlerëson ndikimet shpesh në lidhje me shtresat e reja të puseve (C dhe D).

6.3. Ndikimet e Mundshme në Cilësinë e Ajrit

Për të vlerësuar ndikimet e mundshme në mjedisin e ajrit, është e rëndësishme të identifikohet burimi i shkarkimeve. Burimet e shkarkimeve në ajër mund të klasifikohen në burime pikësore/ stacionare dhe jopikësore/ jostacionare. Burimet e vetme jostacionare që merren parasysh për qëllimin e parashikimit të ndikimit janë shkarkimet e mundshme nga lëvizja e automjeteve. Këto mund të përfshijnë:

- Shkarkimet e gazrave nga motorët dhe lëvizja e automjeteve; Gjenerimi i pluhurit për shkak të lëvizjes së shtuar të automjeteve dhe aktiviteteve të tjera për sheshin e pusit dhe rrugën e re të hyrjes.

Burimet e parashkuara të identifikuar mund të përfshijnë:

- Shkarkimet nga gjeneratorët me naftë;
- Flakërimi i gazit gjatë testimit të pusit;
- Çlirimet/ emetimet si rrjedhojë e aksidenteve të mëdha;

Përshkrimi i ndikimeve të mundshme

Shkarkimet e pluhurave dhe të gazrave mund të ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit në zonën e projektit dhe mund të shkaktojnë shqetësime mjedisore në zonat përreth. Aktivitetet e projektit që do të zhvillohen në vend pritës të shkaktojnë sasi të konsiderueshme të çlirimeve të gazta.

Ndikimet në cilësinë e ajrit në zonën e projektit mund të lindin si rezultat i burimeve të ndryshme të renditura më sipër për aktivitetet e ndërtimit përjashtuar personelin, kampin e përkohshëm të strehimit të punëtorëve, blerjen / marrjen me qira të mjeteve dhe pajisjeve dhe shërbimeve të tjera. Shkarkimet e mundshme të gazrave dhe pluhurit që mund të çlirohen gjatë kësaj faze përcaktohen në sasi dhe shfaqen në Tabelën 46 të Raportit kryesor të VNMS-së për projektin Shpirag-5. Ky përcaktim përlllogarit se gjatë fazës së ndërtimit mund të çlirohen afërsisht 2 kton CO₂. Emetimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit do të rivlerësohen përsëri dhe kuantifikohen para marrjes së lejes mjedisore dhe monitorimit të saj.

Gjatë fazës së Shpimit, Testit Afatshkurtër dhe Afatgjatë të Pusit, burimet kryesore të emetimeve janë grupi i gjeneratorit dhe kulla e flakërimit. Djegia e gazit shoqërues është burimi kryesor i shkarkimeve gjatë vlerësimit afatshkurtër dhe të zgjeruar të pusit. Oxhaku i flakërimit, zakonisht lëshon gazra shoqërues për shkak të djegies së gazit natyror shoqërues nga procesi i kërkimit. Djegia e gazrave shoqërues mund të përfshijë çlirime të CO₂, SO_x, NO_x, madje edhe PM. Shkarkime të tjera të mundshme (p.sh. CO, VOC, gazrat, pluhuri) mund të vijnë nga transporti rrugor, duke përfshirë shkarkimet fluruese për shkak të rregullatorëve të presionit dhe rrjedhjes së sistemeve, të tilla si bashkuesit dhe fllanxhat. Ndotësit që mund të jenë shqetësues përcaktohen në sasi për shkarkimet e gazrave dhe pluhurit në Tabelën 46 të Raportit të VNMS-së Shpirag-5. Gjatë shpimit, Fazat e Vlerësimit Afatshkurtër dhe të Zgjeruar të Pusit parashikohet që një total prej 68 kton CO₂ do të çlirohen në atmosferë. Emetimet në ajër

gjatë fazës së shpimit, testit afatshkurtër dhe afatgjatë të pusit do të rivlerësohen përsëri dhe kuantifikohen pas marrjes së deklaratës mjedisore.

Përshkrimi i receptorëve të mundshëm

Shëndeti i njeriut: Disa shtëpi janë të vendosura përgjatë rrugëve të aksesit (veçanërisht në Dimal (Ish. Ura Vajgurore), Konisbaltë dhe Lagja Hallaxhia e fshatit Pashalli), ku trafiku nga kamionë të rëndë ndodh nga aktivitetet e karrierave. Këtu, duhet të merret parasysh trafiku shtesë nga projekti gjatë ndërtimit, faza e cila mund të përkeqësojë cilësinë e ajrit.

Duke iu referuar të dhënave bazë të cilësisë së ajrit, kushtet në zonën e projektit nuk favorizojnë gjenerimin e pluhurit në shesh për > 70% të kohës. Shtëpia më e afërt është afërsisht 125 metra nga zona, ndërsa fshati Konisbaltë është rreth 300 metra. Distanca e shkollës më të afërt nga zona e propozuar e punës dhe sheshi i pusit është 3.46 kilometra. Receptorë të tjerë si spitalet dhe shkollat ndodhen në një distancë prej 3.5 kilometrash.

Shëndeti i Punëtorëve dhe Komunitetit: Ka më shumë se 29 karriera në një rreze prej 5 kilometrash përreth Zonës së Projektit siç shihet në hartën më poshtë. Efektet kumulative të këtyre burimeve të ndotjes në një distancë të afërt ose në të njëjtën zonë mund të paraqesin rreziqe për ndikime negative në shëndetin e punëtorëve të projektit dhe komunitetit të zonës.




Figure 5. Karriera guri që veprojnë në zonë

Degradimi i habitateve nga shkarkimet në ajër, pluhuri dhe si rrjedhojë e ndotësve të tjerë (toka dhe uji). Habitatet mund të degradohen për shkak të ndotjes nga shkarkimet në ajër dhe pluhurit nga aktiviteti i projektit. Degradimi i habitatit gjithashtu mund të lindë nga ndotësit që derdhen aksidentalisht ose rrjedhin në tokë ose ujë (nëntokësor).

Ndikimet e mundshme në cilësinë e Ajrit gjatë fazës së Ndërtimit.

Aktivitetet e ndërtimit në zonën e propozuar dhe lëvizja e automjeteve përgjatë rrugëve të hyrjes në disa raste do të jenë afër fshatrave ekzistues. Shkarkimet e pluhurave mund të shkaktojnë efekte të pafavorshme shëndetësore dhe shqetësime për banorët vendas, si dhe dëme në kulturat bujqësore. Duke marrë parasysh receptorët përreth dhe ndjeshmërinë e tyre, ndikimet e mundshme nga shkarkimet e pluhurit vlerësohen të jenë me **rëndësi mesatare** për disa receptorë brenda rrezes 500 metra dhe të një **rëndësie të vogël** për receptorët që variojnë nga 500 metra deri në 700 metra dhe **të parëndësishëm** për receptorët në mbi 700 metra distancë, para marrjes së masave zbutëse.

Ndikimet e mundshme në cilësinë e Ajrit gjatë fazave të vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të testimit të Pusit

Gjatë Shpimit dhe fazave të vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të testimit të pusit ndikimet e mundshme në cilësinë e ajrit parashikohet të jenë me **rëndësi mesatare**. Shkarkimet e parashikueshme mund të vijnë nga trafiku rrugor, djegja e gazit (kulla e flakërimit) dhe funksionimi i gjeneratorit. Sidoqoftë, numri i automjeteve gjatë këtyre fazave konsiderohet të jetë dukshëm më i ulët krahasuar me fazën e ndërtimit dhe i papërfillshëm për sa i përket ndikimeve në cilësinë e ajrit nga transporti. Ndikim i rëndësishëm në cilësinë e ajrit mundet të vijnë nga burimet e tjera operationale siç përshkruhen në paragrafin **Error! Reference source not found.** dhe **Error! Reference source not found.** më sipër. Vlerësimi përfundimtar i rëndësisë së ndikimit gjatë Fazave të Shpimit dhe të vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të testimit të pusit konsiderohet si **ndikim** i madh. Ky vlerësim është bazuar në sa vijon:

- Matjet fillestare dhe nivelet e shkarkimeve gjatë periudhës së testimit të puseve.
- Vlerat bazë të matura për cilësinë ekzistuese të ajrit janë mbi vlerat e lejuar standarde, prandaj edhe një emetim i vogël do të rezultojë të ketë ndikime të larta në cilësinë e ajrit.

Ndikimet e mundshme në cilësinë e Ajrit gjatë fazës së Çmobimizimit

Çaktivizimi do të përfshijë braktisjen, çmobimizimin dhe heqjen e strukturave të përkohshme si zyrat dhe ndërtesat e akomodimit, gjeneratorët dhe pajisjet elektrike dhe instalimet, etj.

Bazuar në praktikën më të mira dhe nivelin e aktivitetit të punës, çmobilizimi i pajisjeve zgjat afërsisht 1 muaj, procesi i braktisjes së puseve zgjat 1-2 muaj dhe rehabilitimi i shesheve të puseve të vlerësimit zgjat rreth 5 muaj.

Hapat kryesorë përfshijnë:

- Riparim gropash;
- Përgatitja dhe Rimbjellja;
- Rehabilitimi përfundimtar;
- Riparimi i Rrugës së aksesit.

Një Plan i Rehabilitimit dhe Braktisjes do të zhvillohet në përputhje me kushtet e Lejes Mjedisore, për të siguruar informacion të detajuar mbi skenarët e rehabilitimit.

Ndikimet gjatë çmobilizimit do të jenë njësoj si për fazën e ndërtimit, kryesisht duke gjeneruar pluhur gjatë aktiviteteve të çmobilizimit dhe shkarkime nga lëvizja e automjeteve. Shkarkimet do të ndodhin dhe do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ajrit lokal. Zona e Influcës e ndikimeve të tilla do të jetë kryesisht në afërsi të gjurmës së bllokut të pusit dhe pranë rrugëve të hyrjes. Magnituda / ashpërsia e këtij ndikimi konsiderohet **mesatare**. Rëndësia përgjithshme e këtij ndikimi konsiderohet **mesatare** para marrjes së masave zbutëse. Prandaj, masat që do të merren në fazën e ndërtimit duhet të merren edhe gjatë fazës së braktisjes, çmobimizimit dhe rehabilitimit.

6.4. Potential Impacts from Odour generation

Komponimet kundërmuese mund të shkaktojnë bezdisje në nuhatjen e banorëve dhe gjithashtu mund të afektojnë faunën. Burimi kryesor i aromave janë komponimet e paqëndrueshme në naftën e nxjerrë gjatë vlerësimit të pusit dhe përfshin H₂S dhe komponentë të tjerë që përmbajnë squfur si merkaptanët së bashku me hidrokarburet aromatike ciklike të tillë si benzeni.

Përshkrimi i ndikimeve të mundshme

Merkaptan metili është një gaz pa ngjyrë i djegshëm me një aromë të pakëndëshme dhe që ndizet lehtë. Kur nxehet për t'u shpërbërë, ai çliron një tym helmues dhe avuj të ndezshëm. Avujt nga gazi merkaptan metal i lëngëzuar janë më të rëndë se ajri dhe mund të grumbullohen në zona të ulta. Bezdia nga aromat mund të pengojë njoftimin/ identifikimin e menjëhershëm të përqendrimeve të gazeve të tjerë të dëmshëm.

Merkaptan metili është shumë irritues kur bie në kontakt me pjesë të trupit si sytë, lëkura dhe trakti i sipërm respirator. Gjithashtu efektet mund të përfshijë dhimbje koke, marrje mendsh, të përziera, të vjella, gjendje kome dhe vdekje. Marrja ose gëlltitja e merkaptan metilit ka pak gjasë të ndodhë duke qenë se është një gaz që avullon në temperaturën e ajrit.

Përshkrimi i receptorëve të mundshëm

- Shëndeti i njeriut: Fshati Konisbaltë ndodhet 300 metra nga zona e sheshit.
- Shëndeti i punëtorëve: Receptorë të rëndësishëm janë punëtorët e karrierve në zonë. Efekti kumulative i të gjitha këtyre ndotjeve në të njëjtën zonë mund të dëmtojë shëndetin e punëtorëve nëse nuk merren masa mbrojtëse.

Ndikimet e mundshme nga gjenerimi i Aromës gjatë fazës së Ndërtimit

Aromat gjatë ndërtimit do të çlirohen vetëm në rast të derdhjeve aksidentale (hidrokarbure dhe vajra) nga makineritë / pajisjet e rënda. Mundësia e ndikimit nga derdhjet aksidentale konsiderohet të jetë e ulët, dhe madhësia vlerësohet të jetë e vogël. Çlirimi i mundshëm i aromave në receptorët përreth konsiderohet të ketë një rëndësi të vogël për disa receptorë brenda rrezes 100 metra dhe ndoshta do të ketë ndikime të parëndësishme për receptorët mbi 100 metra nga zona, para zbutjes.

Ndikimet e mundshme nga gjenerimi i Aromës gjatë Shpimit dhe fazave të Vlerësimit Afatshkurtër dhe të Zgjeruar të Pusit

Gjatë të dy fazave, asaj të Shpimit dhe vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të pusit, rreziqet dhe ndikimet e mundshme nga gjenerimi i aromave parashikohen të jenë më të larta se në fazën e ndërtimit. Shkarkimet e mundshme mund të vijnë nga një sërë aktivitetesh, duke përfshirë derdhjet aksidentale nga makineritë e rënda, shkarkimet aksidentale që mund të çlirohen nga baltat e shpimit dhe (në mënyrë të papritur) gjatë operacioneve të shpimit (kryesisht gazi natyror dhe ndoshta H₂S dhe VOC), emetimet fluruese nga pajisjet e procesit, djegies së gazit dhe funksionimit të gjeneratorit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që Shell ka një përvojë të madhe në këto lloj aktivitetesh kërkimore, ata janë të përkushtuar të ndërmarrin teknikat e duhura të menaxhimit për të kontrolluar rastet aksidentale dhe rastet e ndryshme të ndërlikuara gjatë operimit. Për këto lloj aktivitetesh Shell i bën reference Standardeve të saj të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit⁶. Kjo ul disi rreziqet e mundshme gjatë kësaj faze. Prandaj, ndjeshmëria e zonës dhe receptorëve vlerësohet të ketë një rëndësi të mesme. Madhësia e ndikimit është e mesme, vlerësimi përfundimtar i rëndësisë së ndikimit gjatë fazave të shpimit dhe vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të pusit është i mesatar.

Ndikimet e mundshme nga Aromat gjatë fazës së Çmobilizimit

Gjenerimi i aromës gjatë fazës së nxjerrjes nga përdorimi janë të rëndësishme që të merren parasysh vetëm në rast të braktisjes jo të duhur të puseve të vlerësimit. Në këtë rast, ekzistojnë rreziqe të mundshme afatgjata për shkak të rrjedhjeve të mundshme të pusit (gazi natyror, H₂S). Pa marrjen e

⁶ <https://www.shellcontractor.com/shells-hsse-sp-policy/>

masave shtesë ka një ndryshim të lartë dhe mundësi që aroma e merkaptanëve gjatë procesit të çmobilizimit të pusit përkatës do të ndodhë edhe në Shpirag 5. Zona e ndikimit mund të jetë mjaft larg shtresës së pusit në varësi të drejtimit të erës. Sidoqoftë, kohëzgjatja e tij është e kufizuar në disa javë para se të merren masat.

Ndikimi nga braktisja jo e duhur mund të jetë afatgjatë dhe të shkaktojë efekte të konsiderueshme për të gjithë receptorët në rajon brenda rrezes së 500 metrave (banorët dhe punëtorët e karriera) dhe ndikim të mundshëm mesatar për receptorët mbi 500 metra nga zona. H₂S irriton mukozat e trupit dhe traktin respirator. Pas ekspozimit, simptomat afatshkurtra ose akute, mund të përfshijnë një dhimbje koke, të përziera, konvulsione dhe acarim të syve dhe lëkurës.

6.5. Ndikimet e mundshme nga Zhurmat, Dridhjet dhe Ndrëçimi

Gjatë zhvillimit të projektit mund të krijohet bezdisje shtesë nga zhurmat dhe ndrëçimi, që si pasojë mund të ndikojnë negativisht komunitetet lokale dhe faunën në zonë. Ndikimet mund të ndodhin më së shumti afër sheshit të pusit (zonës së projektit) dhe përgjatë rrugëve hyrëse për shkak të krijimit të zhurmës dhe në fshatrat Konisbaltë dhe Pashalli për shkak të ndrëçimit. Aktivitete të ndryshme mund të shkaktojnë ndikime të mundshme, përfshirë:

- Trafiku i shtuar shkakton ndikime për gjenerimin e zhurmave. Trafiku që lidhet me projektin është i kufizuar vetëm gjatë ditës, për pasojë ndikimet nga ndrëçimi janë minimale;
- Aktivitetet ndërtime dhe të shpimit shkaktojnë ndikimet kryesore nga zhurma dhe në një masë më të vogël nga ndrëçimi;
- Djegia e gazit shoqëruar gjatë vlerësimit afatshkurtër dhe të zgjeruar të pusit rezulton në çlirime të zhurmës dhe ndrëçimit;
- Sheshi i pusit do të ndrëçohet natën duke rezultuar në emetime të ndrëçimit.

Shënim: pozicioni i ngritur i puseve alternative të vlerësimit, specifikisht pusit D, mund të rrisë ndikimet që lidhen me zhurmën dhe ndrëçimin. Gjithashtu, kushtet e motit mund të ndryshojnë ndikimin, p.sh. era mund të bëjë që zhurma të udhëtojë më shumë në një drejtim dhe mjegulla / shiu mund të bëjë që drita e dukshme të jetë më pak e ndritshme ose kur kemi ditë me re drita mund të shihet nga distanca e mëtejshme

Zona e projektit është e ndikuar nga disa aktivitete ekzistuese të cilat shkaktojnë çlirime të zhurmës. Burimet kryesore janë:

- Operacionet minerare në karrierat e afërta;
- Zhurma nga trafiku në rrugën lidhëse Pashalli – Mbreshtan;

Niveli mesatar i zhurmës së matur gjatë ditës në afërsi të ndërtesave të banimit është 45.9-48.3 dB(A) dhe gjatë natës është 39.8-48.2 dB(A). Kjo përkon me standartin shqiptar⁷. Pra, niveli bazë i zhurmës në zonën e projektit mund të konsiderohet i lartë.

Përshkrimi i ndikimeve të mundshme

Aktivitetet që kryhen në lidhje me shpimin e puseve nga pajisje të tilla si gjeneratorë, sonda, tubo çeliku, makineri të rënda, mund të rrisin nivelet e zhurmës në afërsi të zonës së projektit dhe mund të shkaktojnë shqetësime mjedisore në zonat përreth.

Projekti do të shkaktojë një shtim të ndrëçimit artificial në zonën e puseve të vlerësimit. Ende nuk është e qartë se ç'loj ndrëçimi do të përdoret. Ka më shumë mundësi të ketë drita për të ndrëçuar vendet e punës për të lehtësuar kushtet e sigurisë në punë.

⁷Udhëzimi Nr. 8 (27.11.2007) i Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Shëndetësisë mbi "Nivelet e zhurmës në mjedis të ndryshme", përcakton vlerat numerike të zhurmës në zona specifike dhe synon të sigurojë ekspozim adekuat të zhurmës për të mbrojtur shëndetin e njeriut.

Ndriçimi shkakton ndikime negative veçanërisht tek kafshët e natës dhe insektet. Ndotja për shkak të ndriçimit ndryshon mjedisin e natës. Kjo bëhet shkak që disa kafshë të braktisin zonat e ndriçuara duke humbur habitatin dhe mundësitë për ushqim apo riprodhim. Lloje të tjerë tërhiqen nga ndriçimi, duke e ekspozuar veten ndaj predatorëve (grabitqarëve) apo humbasin sjelljet e tyre natyrore. Veçanërisht insektet e natës mund tërhiqen edhe nga distanca të largëta drejt dritave artificiale dhe të vërtiten rreth tyre derisa vdesin nga nxehtësia ose lodhja ose bien pre e predatorëve të mundshëm. Shpesh këta insekte të natës kanë funksione të rëndësishëm ekologjikë si burim ushqimi për shpendët dhe lakuriqët e natës apo si transportues të pjalmnit për bimët.

Përshkrimi i receptorëve të mundshëm

Shëndeti i njerëzve: Matjet e kryera nga Konsulenti tregojnë se niveli bazë/ ekzitues i zhurmës në Konisbaltë gjatë ditës është ndërmjet vlerave 45.9-48.3 dB(A) dhe gjatë natës është 39.8-48.2 dB(A). Për shkak të konkurrencës me gjendjen ekzistuese të nivelit të zhurmës (nivel i lartë i zhurmave ekzistuese), mund të ketë një ndikim (të vogël) negativ në popullatën e përgjithshme rajonale të Konisbaltës. Fshati Konisbaltë është relativisht zona më e ndriçuar në afërsi të shesheve të propozuar të pusit. Pjesa e sipërme e luginës dhe të gjithë shpatet janë më së shumti të çliruar nga ndriçimi artificial. Shtimi i ndriçimit do të ndikojë një zonë të gjerë përderisa dritat do të duken që larg. Efekti i ndriçimit të vegjetacionit dhe habitateve është i kufizuar në një maksimum prej disa qindra metrash dhe me shumë mundësi edhe më pak nëse përdoren llambat e duhura. Vetëm brenda kësaj zone ka një ndikim të mundshëm tek gjitarët, shpendët dhe amfibët.

Zhurmat dhe dridhjet/ vibrimet kumulative nga karrierat/ guroret në rrezen e pesë kilometrave nga Zona e Projektit, si tregohet në mënyrë hartografike në Figura 3- **Error! Reference source not found.** mund të rezultojnë në ndikime negative në shëndetin e banorëve në afërsi të zonës së projektit. Ekziston mundësia që zhurmat dhe dridhjet mund të kenë ndikime në shëndetin e punonjësve të projektit që mund të adresohen përmes procedurave të Shell për Shëndetin, Sigurinë dhe Mjedisin.

Degradimi i habitatit nga zhurma dhe shtimi i ndriçimit. Shtimi në nivelet e ndriçimit mund të shkaktojë shqetësimin e kafshëve të egra, të pengojë komunikimin e tyre dhe aftësitë e dëgjimit dhe/apo të ndjehen më të stresuar (gjë që redukton procesin riprodhues). Në përgjithësi, efekti negativ është se kafshët largohen nga zonat me nivele të larta të zhurmës. Për disa kafshë, pragu është 40-42 dB, ndërsa lloje ose individë të tjerë nuk tregojnë efekte deri në 50 ose edhe 60 dB. Efektet tek shpendët janë studiuar më mirë dhe në përgjithësi zvogëlimi i dendësisë dhe suksesit të riprodhimit është vërejtur për nivele nga 42-45 dB e lart.

6.5.1. Modelimi i Zhurmave

Ndikimet e mundshme nga Zhurma dhe ndriçimi gjatë fazës së Ndërtimit dhe Çmobilizimit

Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimet lokale negative mesatare janë të pritshme në zonën ngjitur me zonën e projektit në studim. Çlirimet e zhurmës gjatë fazës së ndërtimit do të burojnë kryesisht nga sa vijon:

- Aktiviteti i makinerive/mjeteve të ndërtimit.
- Levizja e mjeteve të rënda nga dhe në zonat e ndërtimit dhe
- Trafiku për shkak të transportit të personelit.

Makineritë dhe mjetet që përdoren në punimet e ndërtimit konsiderohen si burimet më kryesore të zhurmës. Zhurma shtesë që krijohet nga lëvizja e mjeteve të rënda në rrjetin rrugor të zonës është në shumicën e rasteve nga mesatare në e papërfillshme. Zhurma e krijuar nga mjetet e punëtorëve është thuajse e papërfillshme.

Zhurma e krijuar varet nga distanca e zonës së projektit nga marrësi/receptorët, reflektimi i tingullit, ekzistenca ose jo e pengesave natyrore ose artificiale, nga kushtet meteorologjike dhe lloji i sipërfaqes midis zonës së punimeve dhe marrësit.

Ndikimet në mjedisin akustik nga ndërtimi i projektit, zakonisht cilësohen si pjesërisht të zbutura, meqënëse vendi i punimeve mund të rrethohet nga barriera zhurme të lëvizshme të përkohshme.

Ndikimet konsiderohen si afatshkurtër (8 muaj) meqë ato do të zgjasin deri në fund të periudhës së ndërtimit dhe lokalizohen (deri në 500-600 metër). Magnituda e ndikimit është e moderuar dhe ndjeshmëria e receptorit është e moderuar, e si rrjedhim edhe ndikimi në mjedisin akustik është i **Moderuar**. Ndikimet e zhurmës, me marrjen e masave të përshtatshme zbutëse, mund të zvogëlohen në **minimale**.

Për më tepër, gjatë fazës së ndërtimit do të ketë mbivendosje në aktivitetet gjeneruese të zhurmës me aktivitete të tjera në zonë pasi në afërsi të zonës së projektit ka gurorë, nyje fraksionimi dhe impiant betoni. Këto janë shqyrtuar më hollësisht në seksionin 7.13 - Ndikimet Kumulative.

Niveli i zhurmave dhe ndriçimit – Vlerësimi i ndikimit gjatë Shpimit dhe Fazave të Testimit Afatshkurter dhe Afatgjatë të Puseve

Gjatë Shpimit dhe Fazave të Testimit të Afatshkurtër dhe Afatgjatë të Puseve, Zhurma dhe ndriçimi nga aktivitetet e testimit (gjeneratorë, procesi i trajtimit dhe ndriçimi i sheshit të pusit) do të shtohen. Duke marrë në konsideratë të dhënat fillestare të niveleve ekzistuese do të paraqitet në total një shtim prej 3-4 dBA. Rrjedhimisht, në fazën operacionale të projektit, ndikimet në mjedisin e zhurmës do të jenë **mesatarisht negative**.




Figura 3. Modelimi i niveleve të zhurmave gjatë aktiviteteve të shpimit, sheshi i pusit D – gjatë ditës




Figura 4. Modelimi i niveleve të zhurmave gjatë aktiviteteve të shpimit, sheshi i pusit D – gjatë natës

6.6. Ndikimet e mundshme në Tokë

Substancat ndotëse të lidhura me produktet e naftës mund të rrjedhin dhe të ndotin tokën. Ndikimet, nëse ndodhin, mund të jenë të qëndrueshme/ përhershme, por ato ndodhin zakonisht në afërsi të aktivitetit shpues dhe prodhues. Ndotja mund të jetë e ndryshueshme në varësi të metodave dhe materialeve të përdorura dhe ngjarjeve të derdhjeve aksidentale. Nivelet e agjentëve ndotës mund të mos përbëjnë një kërcënim mjedisor të menjëhershëm, por mund të ketë efekte kumulative afatgjata në ndryshimin e tokës si dhe efekte toksike në organizma.

Përshkrimi i Ndikimeve të Mundshme

Ndjeshëmria e receptorëve të tokës është e varur nga gjendja e vendit dhe karakteristikat e tokës. Në vendndodhjen e pusit D të Shpirag-5 cilësia e tokës është e kategorisë së ulët, e fragmentuar, e ndodhur në formacione gëlqerore dhe me ndërthurje flishi me shkëmbinj karbonatikë. Kështu, toka në këtë zonë përfaqësohet nga vegetacioni i varfër. Pusët e vlerësimit C dhe D do të kërkojnë një sipërfaqe prej rreth 43839.8 m² për alternativën D dhe 89043.1 m² për alternativën C. Deri në 290,000 m³ metra dhera (shtresë e sipërme) do të hiqen për pusin e pusit D, ndërsa për pusin C është parashikuar një sasi prej rreth 100,000 m³ dhe (shtresë e tokës së sipërme). Ndryshimi në aktivitetet e gërmimit dhe mbushjes është se, në rastin pusit D do të kemi më shumë gërmime dhe më pak mbushje ndërsa në rastin pusit C do të përdoret një pjesë të materialit për mbushje kështu që sasi të gjeneruara do të jenë më pak dukshme.

Tokat Regosol dhe sipërfaqet nuk shërbejnë për aktivitet bujqësor. Aktivitetet e ndërtimit mund të ndikojnë karakteristikat e tokës; ato mund të ndikojnë gjithashtu edhe përdorimin aktual apo të ardhshëm të tokës në afërsi të zonës së projektit.

Ndikimet e mundshme në Tokë gjatë fazës së Ndërtimit

Ndikimet në vendin e ndërtimit lidhen me impiantin kryesor dhe me aktivitetet e ndërtimit në vendet e shpimit të pusit. Gërmimi dhe lëvizja e makinerive të rënda në sipërfaqet e pashtuara të tokës gjatë përgatitjes së sheshit të ndërtimit, punimet e tokës dhe hedhja e themelit në zonën e projektit do të destabilizojë strukturën ekzistuese të tokës duke e bërë atë më të prirur ndaj erozionit të ujërave sipërfaqësorë të shiut dhe erozionit nga erërat. Megjithatë, sipas nevojës do të instalohen kanale drenazhimi të përkohshme, gardhe/ rrethime për kapjen e sedimenteve, dhe kufizime në formën e barrierave nga kontraktorët e Shell për të kontrolluar erozionin e tokës apo zhvendosjet për shkak të aktiviteteve paraprake në vendin e ndërtimit.

Gjatë fazës së ndërtimit, do të nevojitet një numër i lartë personeli (deri në 100 persona gjatë pikut të ndërtimit). Megjithëse, ky numër i lartë i punëtorëve do të kërkonte ndërtimin e një kampi akomodimi dhe ambienteve të shërbimit, kjo nuk do të bëhet për arsye sepse ekziston kampi i Shpirag-4 i cili do të përdoret për akomodimin e punonjësve.

Ndikimet e mundshme mund të rezultojnë nga derdhjet e rastësishme të naftës nga pajisjet e ndërtimit dhe rrjedhjet e mundshme nga kanalizimet sanitare, të cilat mund të çojnë në ndotje të tokës dhe të ndryshojnë karakteristikat e saj përmes futjes së lëndës organike koliforme dhe/apo biodegraduese.

Sidoqoftë, për shkak të cilësisë së ulët të tokës dhe ndjeshmërisë së ulët të zonës, pavarësisht lokalizimit të ndikimit dhe qëndrueshmërisë gjatë fazës së ndërtimit (për 8 muaj), rëndësia e këtyre ndikimeve konsiderohet **minimale** përpara marrjes së masave zbutëse.

Ndikimet e mundshme në Tokë gjatë Shpimit dhe fazës afatshkurtër dhe afatgjatë të Testimit të Pusit

Gjatë Shpimit dhe Fazës afatshkurtër dhe afatgjatë të Testimit të Pusit cilësia e tokës mund të ndikohet nga derdhjet aksidentale të materialeve të rrezikshme të tilla si karburante, kimikate dhe produkte të mbetjeve gjatë transportit, ndërtimit, dhe shpimit, vlerësimit të pusit dhe operacioneve të braktisjes. Ndotja e mundshme e tokave është e kufizuar në hapësirë brenda gjurmës së sheshit të pusit dhe rrugës së re të aksesit.

Mbetjet e lëngëta të krijuara gjatë operacioneve të shpimit që mund të shkarkohen direkt përfshijnë ujërat larës të sondës dhe ata të reshjeve që bien brenda sheshit (nëse nuk janë të ndotur). Megjithatë operacionet e shpimit krijojnë në përgjithësi volume të vegjël mbetjesh të lëngëta jo të rrezikshme krahasuar me aktivitete të tjerë industrialë.

Kompleksiteti ose rrjedhja e materialit në vendet e magazinimit si edhe përdorimi i mjeteve për transportin e produktit dhe materialit mund të rezultojë në derdhje të lokalizuara dhe rrjedhje të karburantit/naftës/lubrifikantëve të cilat potencialisht mund të degradojnë cilësinë e tokës dukë futur ndotës që nuk gjenden në tokë. Por, duke patur parasysh cilësinë e tokës, ndjeshmërinë e ulët të zonës/receptorëve, vendin e ndikimit, dhe kohëzgjatjen (qedrueshmërinë) afat mesëm të ndikimit, rëndësia e ndikimit të prishëm në tokë konsiderohet **e moderuar** përpara marrjes së masave zbutëse.

Ndikimet e mundshme në Tokë gjatë fazës së çmobilizimit

Pas mbylljes dhe braktisjes, pusi do të ndërpritet disa metra në nivelin e sipërfaqes dhe pjesa mbi të do të mbushet me dhe vegjetal. Para se të ndërmerret ndonjë aktivitet rehabilitimi, do të zhvillohet një konsultë me palët e interesit duke përfshirë e përfaqësuesit e komunitetit, si dhe të autoriteteve shtetërore. Bazuar në kërkesat e autoriteteve dhe palëve të interesit, Shell do të vendosë për aktivitetet e rehabilitimeve që do të ndodhin në zonën e projektit.

Prandaj, përtej masave rehabilituese që do të merren në kohën e mbylljes/ braktisjes së projektit është shumë e rëndësishme të monitorohet zona edhe pas kësaj faze. Megjithatë, vlen të theksohet se ka pak të gjasa që nga Shell dhe kontraktorët e tij kryejnë një çmobilizim/ braktisje të papërshtatshme. Ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze parashikohen të jenë të ngjashme me fazën e ndërtimit, dhe si rrjedhim

rëndësia e ndikimeve të prishme në tokë konsiderohet të jetë **minimale** përpara marrjes së masave zbutëse.⁸

6.7. Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore

Ndikimet në cilësinë e ujërave nëntokësore gjatë fazës së ndërtimit mund të rezultojnë nga derdhjet aksidentale gjatë proceseve të gërmimit në sheshet e përcaktuara, vendet e mirëmbajtjes/punëtoria e makinerive të ndërtimit apo edhe nga rrjedhjet nga sistemi i grumbullimit të mbetjeve ujore për ambientet sanitare që ndodhen në vendin e punës, si edhe ndotja e mundshme që rezulton nga asgjësimi i materialit. Këto ndikime mund të sjellin infiltrimin e lëndës organike, hidrokarbureve (naftës), koliformëve apo metaleve të rënda në akuiferin e ujërave nëntokësore. Ndotja nga lëndët organike ose ndotja nga hidrokarburet mund të rrisë ngarkesën biokimike të oksigjenit (NBO/ NBO) në ujërat nëntokësore.

Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore gjatë fazës së ndërtimit

Gjatë fazës së ndërtimit do të ketë ndikime të konsiderueshme për shkak të ndryshimeve gjeologjike dhe hidrogjeologjike. Punimet e ndërtimit që do të kryhen në pusët e vlerësimit C dhe D të Shpirag-5 do të zhvillohen kryesisht mbi tokë.

Praktikat e dobëta menaxhuese gjatë ndërtimit mund të jenë potencial për ndotjen që shkarkohet në ujëra nëntokësore ,gjë që varet nga thellësia e ujërave nëntokësore dhe përshkueshmëria e materialit gjeologjik.⁹

Ndikimet karakterizohen si afatshkurtra dhe parashikohet që ato do të zgjasin vetëm brenda kësaj faze. Magnituda e impaktit është **mesatare** dhe ndryshueshmëria e receptorit është mesatare, prandaj ndikimi i përgjithshëm në ujërat nëntokësore konsiderohet **i moderuar** para marrjes së masave zbutëse.

Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësore gjatë fazës së aktiviteteve të shpimit dhe fazës së vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë të pusit

Shpimi i pusit dhe aktiviteti i vlerësimit afatshkurtër dhe afatgjatë në lidhje me pusin Shpirag-5 përfshin hapjen e një pusi të vetëm në terrenin kodrinor të zonës së projektit. Ndikimi i mundshëm në ujërat nëntokësore do të vijë kryesisht nga aktivitetet e shpimit, të cilat do të ndryshojnë strukturën gjeologjike të tokës dhe atë të nëntokës. Nëse mbulimi i pusit dhe çimentimi (i trefishtë) nuk e vulos/ izolon plotësisht pusin, mund të ndodhin rrjedhje në formacionet nëntokësore. Akuiferët mund të kenë ndikim nga ujëra të tjerë të formacioneve jo të pijshme që dalin jashtë për shkak të ndryshimeve të terrenit gjeologjik.¹⁰

Nëse veshja me unaza çeliku nuk bëhet siç duhet për shkak të punës së dobët çimentuese apo në rast të dëmtimit të veshjeve me unaza çeliku, ato mund të kenë ndikim në ujërat nëntokësore. Qarkullimi i çimentos në prodhimin e veshjeve me unaza çeliku parandalon monitorimin e hapërisës ndërmjet fijeve të veshjes me unaza çeliku përpara i përket ndryshimeve të presioneve të cilat mund të tregojnë rrjedhje ndërmjet veshjeve me unaza çeliku dhe dyshemesë së çimentuar (FracFocus, 2015).¹¹

Ekzistojnë shembuj të veshjeve të unazave prej çeliku dhe plastike të cilat përdoren gjerësisht për shkak të korrozioneve me rezistencë të lartë. Megjithatë, reaksioni i ujit nëntokësor nga veshjet me unaza çeliku mund të rrisë pH e ujit.¹² Burimet përfshijnë:

- Shpërlarja e materialit të veshjes së unazave;
- Sulm kimik (korrozion) në veshjeve të unazave;
- Sorbimi dhe desorbimi;
- Kolonizimi dhe sulmi mikrobik (US EPA, 1991).

⁸ Është klasifikuar e Konsiderueshme në rast të çmobilizimit të papërshtatshëm

⁹ (UNEP/O&G, 1997 dhe Apnea, 2015)

¹⁰http://www.halliburton.com/public/bar/contents/papers_and_articles/web/groundwater_white_paper_djiric_2012.pdf

¹¹<http://www.fracfocus.ca/en/groundwater-protection/well-construction-groundwater-protection>

¹² Assessment and risk analysis of casing and cement impairment in oil and gas wells in Pennsylvania, 2000–2012

Nëse pusi nuk mbyllet në mënyrë që të mos mbyllen porët e formacioneve nëntokë nëpërmjet taposjes së pusit me çimentim, ujërat mund të migrojnë drejt akuiferëve përgjatë strukturës së pusit (Haliburton, 2012)¹³

Ndikime të tjera dytësore mund të lindin si rrjedhim i derdhjeve aksidentale. Derdhjet mund të rezultojnë nga aksidentet e mundshme gjatë transportit të naftës, kimikateve dhe mbetjeve të rrezikshme. Ndikimet e lidhura mund të përfshijnë ngjarje aksidentale (derdhje, rrjedhje dhe shkarkime të pakontrolluara) për shkak të derdhjes së materialeve të rrezikshme në sheshin e pusit, përfshirë edhe derdhje të karburanteve. Rrjedhjet mund të shkaktohen si efekt i korrozionit, objekteve që bien, mbipresionit, temperaturës së lartë apo dëmtimeve të tjera të lidhura me valvulat, tubacionet dhe instalimet e tjera teknologjike të pusit. Gjithashtu magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në sheshin e pusit mund të krijojë ekspozim ndaj risqeve të mundshme për ndotjen e tokës, sidomos në rastet e praktikave të papërshtatshme të menaxhimit të mbetjeve. Në këtë rast, sistemi i kullimit dhe menaxhimi efektiv i sheshit të pusit do të jenë pika kyçe në zvogëlimin e ndikimeve të mundshme. Ujërat e shirave dhe ujërat grj do të mblidhen nëpërmjet një rrjeti kullimi.

Ndikimi pritet të jetë i lokalizuar, por parashikohet të jetë afatgjatë, kështu që ndikimi i përgjithshëm në ujërat nëntokësorë për shkak të derdhjeve dhe rrjedhjeve pritet të jetë **i Moderuar** para marrjes së masave zbutëse.

Ndikimet e mundshme në ujërat nëntokësorë gjatë fazës së braktisjes së Pusit

Gjatë fazës së braktisjes, pusi mbyllet me strukturë çimentoje. Kjo parandalon gazet dhe lëngjet për të migruar sipër në atmosferë. Ekziston rreziku ose mundësia që braktisja e pusit të mos kryhet në mënyrën e duhur ose që struktura mbrojtëse të degradohet me kalimin e kohës (si pasojë e mjedisit gërryes të rezervës së naftës nga gazi H₂S). Rreziku i migrimit të përbërësve të tretur nga derdhjet apo rrjedhjet mund të rezultojë afatgjatë në akuifer. Avullimi i VOC-ve, depërtimi i ujërave nëntokësore në thellësi dhe ujërave sipërfaqësore ose në tokë. Në atë rast mund të lindin rrugë rrjedhjeje, që lejon gazet dhe naftën të migrojnë sipër në akuiferat e cekëta të ujërave nëntokësorë.¹⁴

Kullimi i ndotësve nga mbetjet e ngurta të akumuluar ose nga ekzistenca e mjedisëve të papërshtatshme të pastrimit mund të arrijnë në ujërat nëntokësorë duke shkaktuar ndotjen e tyre. Duke patur parasysh ndjeshmërinë mesatare të ujërave nëntokësorë dhe periudhën gjatë së cilës mund të vazhdojë ndotja e ujërave nëntokësorë, ndikimi i mundshëm i ndotjes së ujërave nëntokësorë konsiderohet i **moderuar** para marrjes së masave zbutëse.

6.8. Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë

Në vendndodhjen dhe rrethinat e zonës së projektit, ka pak trupa ujqorë sipërfaqësorë, kryesisht kanale kullimi dhe ujitje. I vetmi trup i madh ujqor është rezervuari i ujit Mbreshtan, i cili ndodhet rreth rreth 3.5 km në juglindje të zonës së Shpirag-5, puseve D ose C, në mes të luginës midis Maleve të Shpiragut dhe Malit të Kules.

Në zonën e projektit ka shumë përrenj që janë në kushte që rrjedhin vetëm sezonalisht. Gjatë periudhës së lagësht të shtatorit deri në maj, këto përrenj mbajnë sasi të konsiderueshme të rrjedhjeve të ujërave të shiut.

Analiza fillestare e cilësisë së ujit tregon një cilësi të moderuar të ujërave sipërfaqësorë në zonë.

Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë mund të lidhen me:

¹³ *Idem*

¹⁴<https://wedocs.unep.org/bitstream/handle/20.500.11822/8275/-Environmental%20Management%20in%20Oil%20%26%20Gas%20Exploration%20%26%20Production-19972123.pdf?sequence=2&isAllowed=y>

- **Grumbullimet e sedimenteve dhe ndryshimi i sasisë së ujërave shpëlarës:** Efektet e grumbullimit të sedimenteve vijnë nga ujërat shpëlarës që mbartin sedimente. Kjo çon në shpëlarje më të shpejtë dhe rrit rrezikun e erozionit dhe përmytjes.
- **Ndotja:** Ujërat sipërfaqësorë mund të ndoten kur ujërat sipërfaqësorë të shiut rrjedhin mbi një derdhje aksidentale.
- **Konsumi i ujit:** Konsumi i burimeve të ujërave sipërfaqësorë (rezervuari i Mbreshtanit) mund të rezultojë në konkurrencë me përdoruesit e tjerë të ujit (nëse të dyja kërkesat për ujë përkojnë). Aktualisht, rezervuari përdoret nga një kompani private lokale për kultivimin e peshkut (akuakulturë). Nxjerrja e ujit mund të ketë risqe për ndikime potenciale të këtij biznesi, ose peshqve në rezervuar.

Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë gjatë fazës së ndërtimit

